

Vlerësim mbi qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale



Expanding
Free Legal Aid
Services



Ky studim u hartua si pjesë e projektit “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri”, që zbatohet nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC). Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë studim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara apo donatorit të tij.

Punoi: Elira Jorgoni, Ardjana Shehi dhe Dritan Shano

© Të gjitha të drejtat të rezervuara UNDP Albania

Tabela e Lëndës

Shkurtime	4
1. Përmbledhje Ekzekutive.....	5
2. Hyrje	13
3. Gjetjet kryesore nga vlerësimi.....	17
3.1. Kuadri ekonomik, ligjor dhe mbrojtja sociale	17
3.1.1. Kuadri ekonomik dhe varfëria.....	17
3.1.2. Standardet ndërkombëtare, garancitë kushtetuese dhe ligjore për mbështetje sociale.....	20
3.1.3. Mbrojtja sociale	24
3.2. Adresimi i varfërisë përmes ndihmës ekonomike dhe zbatimi në praktikë	34
3.3. Fryma e legjislacionit lidhur me pagesat paralele për kategoritë në fokus	45
3.4. Përshtatshmëria e masës së NE	54
3.4.1. Masa e NE e krahasuar me nivelin e varfërisë.....	54
3.4.2. Masa e NE dhe minimumi jetik	57
3.5. Riintegrimi social dhe burimet.....	59
3.5.1. Shpërndarja e burimeve në programet e mbrojtjes sociale	59
3.5.2. Kostimi i shërbimeve të ri-integrimit të Viktimave të Dhunës në Familje ...	61
4. Përfundime e rekomandime	63
5. Referencat.....	72
6. Shtojcat	75
Shtojca 1: Lista e institucioneve të përfshira në intervista e fokus grupe	75
Shtojca 2: Tabela përmbledhëse ligjore.....	76

Shkurtime

AANJ	Anketa të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjeve
ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AK	Aftësi e Kufizuar
AP	Avokati i Popullit
AROPE	Treguesi “Në rrezik varfërie ose përjashtimi social”
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
BB	Banka Botërore
EUROSTAT	Zyra e Statistikave Evropiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
INSTAT	Instituti i Statistikave
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KMCAP	Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KPC	Kodi i Procedurës Civile
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihma Ekonomike
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PNUD	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UM	Urdhër Mbrojtje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UNICEF	Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara
VDF	Viktimë e Dhunës në Familje
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

1. Përmbledhje Ekzekutive

Programi që shënjestron varfërinë është Ndihma Ekonomike (NE) përkufizuar në ligjin nr.57/2019 si “pagesa që u jepet individëve dhe familjeve vulnerabël të përcaktuara në ligj”. Pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor, zbatimi në praktikë i programit të ndihmës ekonomike ka rezultuar sfidues nga këndvështrimi i përfitimit të pagesës së NE nga ana e kategorive përfituese. Raportet dhe të dhënat vjetore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit (AP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), ngrenë shqetësimin e aksesit të kategorive vulnerabël në programin e ndihmës ekonomike nisur nga pasqyrimi i nevojave të tyre në hartimin e programit dhe masën e mbështetjes për një jetesë të denjë e të pavarur. Sipas raportit të AP për vitin 2019 janë regjistruar disa ankesa të paraqitura nga qytetarët, lidhur me aksesin e ndërprerjen e ndihmës ekonomike, nivelin e ulët të masës së përfitimit, si çështje të vazhdueshme ndër vite. Rastet lidhur me përjashtimin apo skualifikimin për të përfituar paralelisht pagesën e ndihmës ekonomike janë referuar pranë AP dhe KMD nga grupe vulnerabël në përgjithësi, përfshirë viktimat e dhunës në familje. Vlerësimi është kryer gjatë periudhës periudhës korrik – dhjetor 2021 dhe është fokusuar kryesisht mbi viktimat e dhunës në familje si kategori e veçantë e përfituesve të NE dhe personat me aftësi të kufizuara.

Iniciativa për të kryer këtë studim u nxit nga rastet e paraqitura pranë dy institucioneve, AP dhe KMD dhe u mbështet me ekspertizë teknike në kuadrin e projektit “Shtrirja e shërbimit ligjor për burrat dhe gratë në Shqipëri”, zbatuar nga PNUD Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim. Konkretisht studimi synon vlerësimin e zbatimit në praktikë të legjisllacionit dhe programit të ndihmës ekonomike me qëllim identifikimin e pengesave që cenojnë aksesin e familjeve në nevojë dhe individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave të ndihmës ekonomike. Vlerësimi synon të shërbejë për të nxitur përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e mbrojtjes sociale, duke theksuar nevojën për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të administratës për zbatimin dhe vlerësimin periodik të politikave sociale në zbatim.

Shqipëria mbetet vendi me nivelin më të lartë të varfërisë në rajon, rreth 33% e popullsisë jeton me më pak se 5.5 dollarë në ditë (BB, 2021a). Rimëkëmbja ekonomike e vitit 2021 ka patur ndikim pozitiv në uljen e varfërisë në Shqipëri. Si pasojë pritet që varfëria në fund të vitit 2021 të arrijë në nivelin e 30.8% të popullsisë (BB, 2021b) përkundrajt 31.8% që ishte në vitin 2019.

Të dhënat e fundit të Matjes së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri (INSTAT, AANJ 2019) tregojnë se individët thellësisht të privuar materialisht përbëjnë 37.1% të popullsisë. Vlerësohet se niveli i varfërisë ose përjashtimit social në Shqipëri - pra i individëve në rrezik varfërie, ose thellësisht të privuar materialisht, ose me intensitet shumë të ulët në punësim është rreth 46.2% e popullsisë (INSTAT, ABF 2019). Rreziku për të qenë i varfër është më i lartë për femrat në nivelin 23.8%, kundrejt meshkujve me 22.2%. Po ashtu, niveli i individëve në rrezik varfërie është më i larti në familjet me fëmijë në varësi, rreth 27.2% e individëve, kundrejt 14.2% që verifikohet në familjet pa fëmijë në varësi.

Çdo pririje pozitive për uljen e varfërisë, mbetet e rrezikuar dhe e paqëndrueshme përkundër mungesës së hapësirës fiskale dhe prioritizimit të shpenzimeve të buxhetit të shtetit, borxhit publik të lartë, nivelit të ulët të produktivitetit të sipërmarrjes, mungesës së konkurrencës në treg dhe institucioneve të dobëta.

Në kuadrin e politikave sektoriale, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020 - 2023) ka si vizion të përgjithshëm ndërtimin e sistemit të mbrojtjes sociale për të luftuar pabarazitë social-ekonomike me politika dhe mekanizma për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar përmes programeve parandaluese dhe riintegritit social të kombinuara me skemat e punësimit. Një nga politikat ku mbështetet strategjia e mbrojtjes sociale është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër. Kjo politikë synon përmirësimin e shënjestrit të tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzimit në skemën e ndihmës ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegritin social të tyre në jetën shoqërore. Më tej, kjo strategji ashtu si dhe Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore (2021-2030) dhe Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2025), ndajnë parimin askush të mos mbetet pas, duke qendëruar barazinë, mbrojtjen e riintegritin social të viktimave të

dhunës apo të personave me aftësi të kufizuara.

Programi i asistencës sociale përfshin, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar dhe ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura si dhe përfitime të tjera, që garantohen përmes ligjit 57/2019. Ndihma ekonomike përbën mbështetjen në para që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë. Skema e pagesave të mbrojtjes sociale zbatohet në praktikë nëpërmjet funksionimit të Regjistrisë Elektronike Kombëtare të Ndihmës Ekonomike dhe Regjistrisë Elektronike Kombëtare të Aftësisë së Kufizuar.

Kategoria e viktimave të dhunës në familje përfaqëson vetëm 0.2% të personave që përfitojnë NE në të gjithë Shqipërinë, ndërsa masa monetare e pagesave përkatëse llogaritet të jetë rreth 0.5% e fondit total të ndihmës ekonomike për vitin 2020. Pagesa mujore prej 3,000 lekë për viktimat e dhunës në familje, e trefishuar nisur nga janari 2022 (VKM 868, datë 29.12.2021) është përcaktuar në legjislacion pa një vlerësim të masës së përshtatshme që i nevojitet kësaj kategorie. Kjo pagesë është e palidhur apo referuar me ndonjë pagesë tjetër, dhe duke qenë se viktimat e dhunës në shumicën e rasteve i përkasin grupeve vulnerabël, nuk përputhet me mjaftueshmërinë përkundër rrezikut për të rënë në varfëri. Rezultati i vlerësimit për shpenzimet mesatare mujore për një familje me 3.7 anëtarë është një tregues tjetër që thekson pamjaftueshmërinë e masës së pagesave të NE. Për vitin 2020 masa mesatare e NE ishte mesatarisht 5,161 lekë ndërkohë që, vlerësimi për shpenzimet mesatare mujore për një familje me 3.7 anëtarë llogaritet në rëndin e 82,235 lekë (INSTAT, ABF 2019). Vetëm shpenzimet për ushqime dhe pije jo-alkolike llogariten të jenë 33,952 lekë.

Alokimet buxhetore për mbrojtjen sociale përmes ndihmës ekonomike dhe pagesave për personat me aftësi të kufizuar kanë reflektuar situatat e vështira që ka kaluar vendi, sidomos lidhur me përballimin e pandemisë Covid-19, duke reflektuar një rritje prej 27.9% në vitin 2020 përkundrajt një viti më parë (2019). Këto alokime buxhetore vijuan rritjen me 17.9% në vitin 2021 në raport me vitin 2020, ndërsa tkurren me 2.7% në parashikimet buxhetore të vitit 2022.

Kuadri ligjor parashikon mbrojtje dhe kujdes social të viktimave të dhunës në familje dhe trajtimin e tyre me pagesa 'cash' nga pagesat e asistencës sociale (pagesat e ndihmës ekonomike dhe pagesat e aftësisë së kufizuar)

e përfitime të tjera që adresojnë individët/familjet në nevojë e grupe të caktuara në Republikën e Shqipërisë. Kuadri ligjor përkatës është i gjerë dhe i komplikuar dhe individëve përkatës, përfshirë viktimat e dhunës në familje u duhet orientim ligjor për të kërkuar dhe zbatuar në mënyrë efektive të drejtat ligjore përkatëse të këtyre individëve e grupeve në nevojë e vulnerabël për mbrojtje dhe kujdes social. Në lidhje me pagesat paralele për viktimat e dhunës në familje, të cilat kualifikohen njëkohësisht edhe si kategori e veçantë apo familje në nevojë, kuadri ligjor ka një dispozita ligjore jo të qarta, të cilat kufizojnë/pengojnë që i njëjti person të marrë paralelisht edhe pagesën ‘cash’ të ndihmës ekonomike si viktimë e dhunës në familje edhe pagesën e NE si pjesëtar/familje në nevojë. Kjo dispozitë ligjore bëhet edhe më e paqartë në kushtet që e drejta ligjore për pagesa të ndryshme i përket plotësisht të kushteve për statuse ligjore të ndryshme. Bazuar në kuadrin ligjor në fuqi, një viktimë e dhunës në familje mund të jetë edhe individ apo pjesëtar/familje në nevojë edhe PAK, etj., dhe dispozitat ligjore kufizojnë/pengojnë mbështetjen në të njëjtë kohë të çdo statusi ligjor në nevojë e vulnerabël me secilën pagesë apo të gjitha pagesat e përfitimet përkatëse të asistencës e kujdesit social. Ky raport, gjithashtu, paraqet një analizë të dispozitave ligjore përkatëse për të identifikuar arsyen përse viktimat e dhunës në familje nuk trajtohen njëkohësisht edhe me pagesa për mbështetje për shkak të statusit si viktimë e dhunës në familje edhe me pagesa të asistencës sociale (pagesa NE dhe pagesa PAK) dhe përfitime të tjera të kujdesit social.

Disa nga gjetjet kryesore të identifikuara janë:

Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm. Mungon një qasje e njëjtë për ndarjen e informacionit me publikun përmes institucioneve që ofrojnë shërbime e aksesohen më shpesh nga kategoritë në nevojë. Më tej, kategoritë e veçanta nuk kanë informacion që mund të përfitojnë mbështetje përmes dy modaliteteve (si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë).

Për viktimat e dhunës që janë larguar në një bashki tjetër, **aplikimi pranë bashkisë së origjinës, ku figurojnë të regjistruar është një barrierë që hasin për t’u qasur mbështetjes.** Po ashtu, personat që janë strehuar në strehëza të financuara nga buxheti i shtetit, nuk mund të përfitojnë ndihmë ekonomike gjatë kohës që trajtohen në institucionet publike të përkujdesit (Ligji 597/2019).

Kufizimi për të aplikuar brenda 10 ditëshit të parë të muajit sjell vonesa në përfitim të NE; ndërkohë që sistemi apo edhe vetë bashkitë nuk kanë parashikuar fleksibilitet për të adresuar raste emergjente që i përkasin kategorive të veçanta.

Gjithashtu, janë identifikuar sfida që lidhen me Urdhrat e Mbrojtjes, konkretisht: varësia e përfitimit të NE nga disponimi i Urdhrit të Mbrojtjes (UM) shkakton vonesa të konsiderueshme për marrjen e mbështetjes. Ndërsa, Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes (UMM) nuk njihet nga administratorët shoqërorë si dokument i vlefshëm për të nisur procesin e aplikimit për NE.

Aplikimi i pagesave paralele nuk është i njëjtë në shumë bashki të vendit. Zbatimi i programeve të mbrojtjes, në pasigurinë e interpretimit të qartë ligjor, duket se udhëhiqet nga praktika më e shpeshtë.

Viktima e dhunës në familje mund të aplikojë si familje në nevojë vetëm nëse është në procedurë të zgjidhjes së martesës; ndërkohë detyrimi i pagesës për shërbimin e psikologut në nisjen e procedurës së zgjidhjes së martesës është një kosto e konsiderueshme për këtë kategori. Vërtetimi i situatës si kategori në nevojë bie në kurriz të qytetarëve, çka kthehet në kosto në momentin që kërkojnë mbështetje juridike falas; pra sistemi kthehet në një qark vicioz në momentin kur duhet të aktivizojë mbështetjen konkrete.

Shërbimet që duhet të ofrohen të mirëkoordinuara për kategoritë përfituese janë thelbësore për të siguruar një mbështetje ndërsektoriale e për të mundësuar riintegrimin social të individëve e familjeve në nevojë. **Për viktimat e dhunës në familje, strehimi, punësimi e aksesimi në institucionet arsimore për fëmijët e tyre mbeten nevoja prioritare.**

Masa e pagesave të NE është shumë e ulët e nuk ndihmon në daljen nga cikli i mbyllur i varfërisë, duke i mbajtur grupet e cënueshme në të njëjtat kushte, pa u krijuar mundësi për t'u arsimuar apo zhvilluar që të mund të dalin nga cikeli i varfërisë.

Disa nga rekomandimet kryesore:

Kuadri ligjor duhet të synojë mbështetjen e individit në nevojë e vulnerabël për t'i siguruar një jetë dinjitoze sipas standardeve ndërkombëtare dhe të drejtave kushtetuese përkatëse. Kuadri ligjor duhet të synojë mbështetjen e

njëkohëshme të çdo statusi të të njëjtit individ në nevojë dhe duhet të jetë i shkruar qartë dhe shprehimisht për të siguruar garanci ligjore për përfitim efektiv paralel të pagesave 'cash' nga pagesat e asistencës sociale (pagesat e NE dhe pagesat PAK) dhe të përfitimeve të tjera takuese përkatëse të mbrojtjes dhe kujdesit social.

Sugjerohet adresimi i sfidave që lidhen me aksesin dhe zbatimin e ndihmës ekonomike si mundësimi i aplikimit të viktimave të dhunës të regjistruar si rezidente në bashki tjetër apo qartësimi i ligjit mbi njohjen e UMM në procesin e aplikimit të e NE. Në rastin e vonesave të urdhrave të pazbardhur të krijohet **praktika detyruese bazuar në dispozitat ligjore përkatëse të Kodit të Procedurës Civile (KPC), Neni 308.**

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) duhet të shqyrtojë **mundësinë e ofrimit të pagesave të NE për viktimat e dhunës në familje për rastet emergjente përtej periudhës 10 ditore** të çdo muaji për aplikime, qoftë edhe përmes sistemit apo buxhetit (6%) të administruar nga bashkitë për NE.

Është e nevojshme të bëhen **ndryshime ligjore për të mundësuar jo vetëm pagesa paralele brenda skemës të asistencës sociale (NE dhe PAK) por, edhe përfitime paralele/të njëkohëshme në natyrë e shërbime,** konkretisht për të qartësuar përmbajtjen e nenit 11, pika 'dh', dhe nenit 12 pika 6 të Ligjit për Asistencën Sociale..

Rekomandohet të hartohet një akt nënligjor/udhëzim i veçantë për administratorin shoqëror me synimin për të shmangur diskrecionin ekzistues në dhënien/përfitimin e pagesave dhe përfitimeve të ndihmës ekonomike. Kjo të pararendet me ndryshim ligjor në Ligjin për Asistencën Sociale (neni 23 dhe neni 32).

Është e nevojshme **të udhëzohen strukturat vendore mbi zbatueshmërinë e ligjit lidhur me pagesat paralele/të njëkohëshme** në mënyrë që kategoritë e veçanta të mund të përfitojnë nga masat e ndryshme të mbrojtjes që ofrohen nga sistemi në rastin e vulnerabilitetit të shumëfishtë. Strukturat vendore duhet të informohen mbi programet dhe masën e përfitimit, duke garantuar **shmangien e zbritjes së masës** për viktimën e dhunës e llogaritjen e masës vetëm për fëmijët apo anëtarët e tjerë në varësi, të cilët nuk përfshihen në urdhrin e mbrojtjes.

Pas ndryshimeve ligjore, sugjerohet të rishikohet formulari dhe Regjistri Elektronik Kombëtar që sistemi të pasqyrojë dhe verifikojë saktësisht parashikimet dhe kërkesat e ligjit në fuqi.

Forcimi i kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse në nivel vendor, për të siguruar qartësimin e kuadrit ligjor, zbatimin e duhur të tij dhe ofrimin e informacionit të nevojshëm ligjor për kategoritë në nevojë. Është e nevojshme të hartohet një **plan për ngritjen e kapaciteteve për të gjitha bashkitë** mbi të drejtat dhe udhëzimet lidhur me aksesin dhe aplikimin në pagesat e ndihmës ekonomike të kategorive të ndryshme, bazuar në raste konkrete, për të ilustruar hapat që duhen ndërmarrë, mbështetur në kuadrin ligjor. Duhet fuqizuar **kapacitetet jo vetëm të aktorëve kryesorë pjesë e administrimit të sistemit të asistencës sociale, por dhe ofrues shërbimesh, publikë e jo-publikë (OJF), si dhe institucionet e tjera, pjesë të mekanizmit të referimit. Zyrat e Ndihmës Ligjore** sugjerohen të përfshihen në aktivitete informuese dhe aktivitete fuqizuese mbi të drejtat dhe aksesin e grupeve të ndryshme në sistemin e mbrojtjes sociale.

Rritja e kapaciteteve duhet të kryhet në mënyrë periodike për të gjitha strukturat, duke siguruar që stafet përgjegjëse të jenë të përditësuara me legjislacionin përkatës dhe krijimin e praktikave të punës që sigurojnë dhe aplikimin e saktë përmes sistemit elektronik (Regjistrin Elektronik Kombëtar) dhe zbatimin e sistemit. Mësimet e nxjerra periodikisht nga praktikat e ndryshme në menaxhimin e programit të NE në nivel vendor duhet të shërbejnë për të ushqyer politikë-bërjen në mënyrë që qasja e mbrojtjes sociale të përmirësohet për të garantuar aksesin e barabartë, të informuar e pa diskriminim, për të gjithë individët e familjeve në nevojë në programet e mbrojtjes sociale.

Përmirësimi i bashkëpunimit mes policisë dhe koordinorit të dhunës që në momentin e vlerësimit të riskut do mund të maksimizojë aksesin e individëve të kualifikueshëm në programin e ndihmës ekonomike.

Përmirësimi i informacionit dhe aksesit në programet e mbrojtjes sociale. Antarët e mekanizmit referues, njësitë vendore, si dhe administratorët shoqërorë dhe ekipi i Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve, duhet të përfshijnë në planin e tyre të punës aktivitete të komunikimit periodik përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit e informimit mbi programet e mbrojtjes

sociale dhe aksesimin e tyre. Informacioni mbi rregullat e përfitimit duhet të jetë lehtësisht i kuptueshëm e i aksesueshëm përmes çdo zyre vendore, si dhe në hapësira të tjera publike, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse në nivel vendor.

Është e rëndësishme të kryhen **konsultime teknike të hapura mbi përshtatshmërinë e NE në vendin tonë**, sidomos në kuadër të zbatimit të udhërrëfyesit të hartuar për këtë qëllim. Pjesë e diskutimeve duhet të jetë dhe mundësia e lidhjes mes masës së NE me nivelin e varfërisë apo me pagën minimale. **Mungesa e një reference përshkallëzon arbitraritetin e cënön synimin e zbutjes së varfërisë e sigurimit të një jetë dinjitoze që asnjë të mos mbetet pas.** Përcaktimi i nivelit të ndihmës ekonomike në lidhje/në raport me pagën minimale, do mundësonte përafrimin e këtyre të ardhurave minimale me zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë më transparente (KE, 2019). Gjithashtu, NE dhe përfitimet e tjera duhet të bëhen pjesë e indeksimit periodik, bashkë me pagën minimale. Diskutimet që prekin mjaftueshmërinë e mbështetjes përmes mbrojtjes sociale dhe nivelin e të ardhurave minimale duhet të nxiten në dobi të rishikimit të përshtatshmërisë së masës ekonomike.

Matja e ndikimit të masave për zbutjen e varfërisë duhet të jetë pjesë integrale e veprimeve në zbatim të kuadrit politik të mbrojtjes sociale. Suksesi i masave nuk mund të vlerësohet përmes rritjes arbitrare të masës së NE, por përmes matjes periodike të ndikimit dhe analizave të tjera lidhur me zhvillimin ekonomik dhe nivelin e jetesës së individëve me nevoja të veçanta e familjeve në nevojë. Rezultatet e këtyre analizave duhet të ushqejnë politikëbërjen. Masa e pagesave, dhe në përgjithësi i gjithë sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri do mund të harmonizohet dhe ishte koherente nëse masa e NE do të bazohet mbi referenca konkrete si paga minimale apo minimumi jetik i cili do duhet përcaktuar dhe në legjislacion.

2. / Hyrje /

Qëllimi i studimit dhe objektivat

Ndihma Ekonomike (NE) përkufizohet në ligjin nr.57/2019 si “pagesa që u jepet individëve dhe familjeve vulnerabël të përcaktuara në ligj”. Pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor, zbatimi në praktikë i programit të ndihmës ekonomike ka rezultuar problematik nga këndvështrimi i përfitimit të pagesës së NE nga ana e kategorive përfituese. Gjithashtu, raportet dhe të dhënat vjetore të institucioneve të pavarura kombëtare të të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit (AP) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), duke synuar një standard të arsyeshëm jetese që përputhet me dinjitetin njerëzor dhe të drejtat e njeriut, argumentojnë se kriteret për përfitimin e ndihmës ekonomike bien ndesh me nevojat e kategorive vulnerabël dhe nuk marrin parasysh kufirin e varfërisë, çka ka çuar në përjashtimin e mëtejshëm të këtyre kategorive nga mbrojtja sociale.

Sipas raportit të AP për vitin 2019 janë regjistruar disa ankesa të paraqitura nga qytetarët, lidhur me aksesin e ndërprerjen e ndihmës ekonomike, nivelin e ulët të masës së përfitimit, si çështje të vazhdueshme ndër vite.

Në vitin 2013¹, KMD ka shqyrtuar problematikën e pagesës paralele, në kuadër të një ankese të paraqitur nga një ankuese e cila ishte njëkohësisht person me aftësi të kufizuar dhe viktimë e trafikimit. Ankuesja ishte përfituese e e pagesës së aftësisë së kufizuar, por bashkia kishte refuzuar që t’i jepte pagesën si viktimë trafikimi, pasi ankuesja ishte përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe për rrjedhojë asaj nuk mund t’i llogaritej ndihmë ekonomike si viktimë trafikimi. Komisioneri konstatoi situatën diskriminuese dhe urdhëroi bashkinë që t’i njihte të drejtën ankuseses që të përfitonte të dy pagesat, pagesën si person me aftësi të kufizuar dhe pagesën si viktimë e trafikimit.

1 Vendimi nr.108, date 24.10.2013.

Gjatë vitit 2021, KMD pas një hetimi kryesisht të zhvilluar pas marrjes së informacionit në lidhje me problematikën e hasur nga viktimat e dhunës në familje, të cilat nuk mund të kishin akses paralel në skemën e ndihmës ekonomike, njëkohësisht si viktimat e dhunës në familje dhe si individë/familje në nevojë, ka dërguar një rekomandim për marrjen e masave për rishikimin e pikës 6, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 12, të Kreut III, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, me qëllim sigurimin e aksesit paralel të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare, si viktimat e dhunës dhe si kategori në nevojë, për shkak të mungesës ose pamjaftueshmërisë së të ardhurave. Ky rekomandim i është dërguar Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si një masë për të adresuar dhe parandaluar diskriminimin ndërsektorial me të cilin përballen personat për shkak të vulnerabilitetit të shtuar si pasojë e mbartjes së më shumë se një shkakut të mbrojtur nga diskriminimi.

Ndërsa më herë, gjatë procesit të konsultimit të ligjit “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri ka rekomanduar që të hiqej parashikimi i nenit 12/6, sipas të cilit anëtarit të familjes në nevojë që është person me aftësi të kufizuara, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

Rastet lidhur me përjashtimin apo skualifikimin për të përfituar paralelisht pagesën e ndihmës ekonomike janë referuar pranë AP² nga grupe vulnerabël në përgjithësi, përfshirë viktimat e dhunës në familje. Nisur nga këto raste, u gjykua e nevojshme kryerja e një vlerësimi mbi zbatimin në praktikë të legjislatcionit të ndihmës ekonomike dhe programit të ndihmës ekonomike në përgjithësi me qëllim identifikimin e çështjeve/pengesave kryesore që çënojnë aksesin e familjeve dhe individëve në nevojë e individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave në para (cash) të ndihmës ekonomike . Vlerësimi synon të nxisë përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e mbrojtjes sociale, duke nënvizuar nevojën për rritjen e kapaciteteve të administratës për vlerësimin e politikave sociale në zbatim.

2 AP, Raport Vjetor 2019

Ky vlerësimi është një nismë e AP dhe KMD e mbështetur me ekspertizë teknike në kuadrin e projektit “Shtirja e shërbimit ligjor për burrat dhe gratë në Shqipëri”, zbatuar nga PNUD Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim.

Metodologjia

Në hartimin e metodologjisë së vlerësimit u kombinuan disa metoda kërkimore, duke synuar kombinimin e të dhënave cilësore dhe sasore për të vërtetuar pyetjet e kërkimit dhe për të kryqëzuar gjetjet e përfundimet.

Vlerësimi është kryer gjatë periudhës periudhës korrik – dhjetor 2021, duke u fokusuar në të dhënat e disponueshme për periudhën 2019–2020 me fokusin mbi viktimat e dhunës në familje dhe personat me aftësi të kufizuara. Për lehtësimin e hulumtimit në nivel vendor, në bashkëpunim me AP dhe KMD u përzgjedhën tre bashki, Tiranë, Korçë dhe Mat bazuar në kritere si madhësia, vendndodhja gjeografike, dhe rastet më të shpeshta të paraqitura pranë dy institucioneve.

Puna kërkimore, përfshiu tri faza kryesore:

- (i) **Shqyrtim dokumentacioni dhe analizë e legjislacionit:** rishikimin e raporteve, studimeve dhe të dhënave të disponueshme, si dhe analizën e kuadrit ligjor të zbatueshëm në fuqi të mbrojtjes sociale. Në këtë fazë, u krye hartëzimi i kuadrit ligjor përkatës, në lidhje me ndihmën ekonomike dhe pagesat e tjera për grupet vulnerabël. Pjesë e kësaj detyre ishte përpilimi i një inventari të legjislacionit dhe dokumenteve të tjera përkatëse, të cilat u përdorën si bazë për hartëzimin e kuadrit ligjor. Një element tjetër ishte analiza sasore bazuar në të dhënat administrative të ofruara nga Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) dhe bashkitë, të dhënat e disponueshme përmes anketave të INSTAT të matjes së të ardhurave dhe nivelit të jetesë dhe tregues të tjerë buxhetorë dhe ekonomikë.
- (ii) **Puna në terren,** në mbështetje të vlerësimit cilësor, u fokusua në tri bashkitë e përzgjedhura, bashkitë Tiranë, Korçë dhe Mat. Për këtë qëllim, u organizuan intervista gjysëm të strukturuar e fokus grupe me zyrtarë nga MSHMS, SHSSH, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Drejtoritë

Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, përfaqësues të bashkive dhe të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime e advokues për të drejtat e viktimave të dhunës në familje. Intervistat e fokus grupet shërbyen për të analizuar më tej praktikat e ndryshme të aplikuara gjatë zbatimit të kritereve dhe procedurave për përfitimin e programit të ndihmës ekonomike, barrierat dhe perspektivën e përfituesve.

(iii) Sinteza, analiza e informacionit dhe hartimi i raportit të vlerësimit.

Raporti i vlerësimit përfshin analizën ligjore, dokumentimin e të dhënave dhe praktikave në zbatimin e ndihmës ekonomike fokusuar në çështje të informacionit dhe aksesit, barrierat lidhur me pagesat paralele/e njëkohëshme dhe mbështetjen e riintegrimin e përfituesve të ndihmës ekonomike si familje në nevojë apo kategoritë e veçanta në fokus. Raporti përfshin rekomandime konkrete për ndërhyrjet bazuar në gjetjet e dy fazave të para.

3.

Gjetjet kryesore nga vlerësimi

3.1. Kuadri ekonomik, ligjor dhe mbrojtja sociale

3.1.1. Kuadri ekonomik dhe varfëria

- Perspektiva ekonomike

Ekonomia shqiptare arriti të rezistonte përballë dy goditjeve të mëdha, siç ishte tërmeti i nëntorit 2019 dhe pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020. Efektet negative në ekonomi u minimizuan përmes stimujve fiskalë, dyfishimit të masës së NE, zgjatjes së përfitimeve, subvencionimit të pagave, garancive sovraane në mbështetje të bizneseve. Në total paketat për të përballuar efektet e Covid-19 arritën në 1.4% të PBB³, niveli më i ulët mes vendeve të rajonit. Pasi ekonomia shqiptare regjistroi një tkurrje prej 4% në vitin 2020, qeveria parashikon një rimëkëmbje të fuqishme me një rritje prej 7.2 për qind deri në fund të vitit 2021⁴. Kjo pritshmëri bazohet tek aktiviteti i rindërtimit, reduktimi i kufizimeve të lëvizjes së njerëzve, prodhimi i energjisë, një sezon turistik i mirë, dhe tek rritja e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit 2020 dhe atij 2021, të cilat reflektojnë një defiçit mjaft të lartë buxhetor në nivelin e 6.8% të PBB, ndërsa ishte në nivelet 1.9% të PBB në vitin 2019 dhe 1.6% e PBB në vitin 2018.

Për vitin 2022, qeveria parashikon normalizimin e rritjes ekonomike në nivelin 4.1%. Ky moderim vjen kryesisht për shkak të ngadalësimit të shpenzimeve publike të lidhura me rimëkëmbjen nga tërmeti - defiçiti buxhetor për vitin 2022 parashikohet të tkurret në rreth 5.4%. Në periudhën afatmesme 2022-2024 rritja ekonomike pritet të mbetet në nivelin 4%. Inflacioni për vitin 2022 parashikohet të jetë 2.8%, më i lartë se 2.2% që vlerësohet të jetë në 2021, ose krahasuar me nivelin e 1.6% që ishte në vitin 2020. Përkundër pritshmërisë për rritje të çmimeve edhe gjatë vitit 2022, FMN vëren se hapësirat fiskale që

3 <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/04/10/pr20148-albania-imf-executive-board-approves-us-in-emergency-support-to-combat-covid-19-pandemic>

4 Ligji nr. 115 datë 25.11.2021 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2022" (FZ 197 datë 21.12.2021)

do mund të krijohen nga moderimi i shpenzimeve publike duhet që pjesërisht të sigurojnë mbështetje për shtresat më në nevojë⁵. Qeveria parashikon se niveli i papunësisë për vitin 2022 do të ulet në rreth 10.3% nga 12.2% që ishte në vitin 2020. Qëndrueshmëria e këtyre parashikimeve bazohet te një rritje ekonomike e nxitur nga shpenzimet qeveritare dhe konsumi, më shumë sesa nga ristrukturimi i ekonomisë shqiptare dhe rritja e produktivitetit të saj.

• **Varfëria**

Shqipëria ka nivelin më të lartë të varfërisë në rajon, rreth 33% e popullsisë jeton me më pak se 5.5 dollarë në ditë (BB, 2021a). Gjatë periudhës 2016 - 2018, varfëria ka rënë nga 40 në 32.4% të popullsisë. Tërmeti i nëntorit 2019, i pasuar nga pandemia e Covid-19 e rritën varfërinë përsëri. Në fund të vitit 2020, vlerësohej se varfëria ishte kthyer në nivelet e vitit 2018, ose u rrit me të paktën 1 pikë përqindje (pp) - ekuivalenti i 28,000 personave të varfër të rinj; një vlerësim më konservator projektonte rritje të varfërisë me rreth 4pp ose 112,000 të varfër të rinj në 2020 (BB, 2021a).

Rimëkëmbja ekonomike e regjistruar në vitin 2021 ka patur ndikim pozitiv në uljen e varfërisë në Shqipëri. Pritet që varfëria në fund të vitit 2021 të arrijë në nivelin e 30.8% të popullsisë (BB, 2021b) e cila jeton me më pak se 5.5 dollarë në ditë, ky tregues ishte 32.4% në vitin 2018 (BB, 2021b). Individët thellësisht të privuar materialisht përbëjnë 37.1% të popullsisë. Vlerësohet se niveli i përjashtimit social në Shqipëri - pra i individëve në rrezik varfërie, ose thellësisht të privuar materialisht, ose me intensitet shumë të ulët në punësim është rreth 46.2% e popullsisë (INSTAT, AANJ 2020). Përveç atyre nën kufirin e varfërisë, Eurostat, konfirmon se në vitin 2019, numri i njerëzve në rrezik varfërie në Shqipëri ishte 659,000 persona⁶.

Grupet më vulnerabël ndaj rrezikut të varfërisë i përkasin grup-moshës deri në 17 vjeç, me nivelin më të lartë për femrat 31.7%. Për të gjitha grup-moshat, rreziku për të qenë i varfër është më i lartë për femrat në nivelin 23.8%, kundrejt meshkujve me 22.2%. Po ashtu, niveli i individëve në rrezik varfërie është më i larti në familjet me fëmijë në varësi, rreth 27.2% e individëve, kundrejt 14.2% që verifikohet në familjet pa fëmijë në varësi.

5 <https://www.imf.org/en/News/Articles/2021/10/12/mcs101221-albania-2021-article-iv-consultation-concluding-statement>

6 <https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

Tabela 1: Rreziku i varfërisë sipas grupmoshave dhe gjinisë

Rreziku për të qenë i varfër sipas grupmoshave dhe gjinisë (në %)									
Grupmosha në vjeç	2017			2018			2019		
	M	F	Total	M	F	Total	M	F	Total
0-17	27.7	31.8	29.6	28.7	30.6	29.6	27.9	31.7	29.7
18-64	24.0	23.4	23.7	23.2	23.3	23.2	22.3	23.3	22.8
65+	13.0	13.7	13.4	12.5	15.4	14.0	12.9	14.8	13.9
Gjithsej	23.5	23.9	23.7	23.0	23.8	23.4	22.2	23.8	23.0

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, 2017, 2018, 2019 INSTAT

Pavarësisht rimëkëmbjes ekonomike, Shqipëria mbetet vendi më i varfër i rajonit, ndikuar edhe nga rikuperimi i ngadaltë i pjesëmarrjes së forcave të punës dhe punësimit (BB, 2021b). Vlen të theksohet se këto prirje pozitive për reduktimin e varfërisë, që verifikohen me rimëkëmbjen ekonomike janë të rrezikuara dhe të paqëndrueshme përkundër mungesës së hapësirës fiskale, borxhit publik të lartë, nivelit të ulët të produktivitetit të sipërmarrjes, mungesës së konkurrencës në treg dhe institucioneve të dobëta.

Ndërsa rritja ekonomike për periudhën afatmesme 2022-2024 parashikohet e moderuar në nivelet nga 4.1 në 3.9%, rritja e pritshme e çmimeve për shkak të ekspozimit të ekonomisë shqiptare ndaj asaj evropiane dhe politikave qeveritare kundrejt çmimit të energjisë pritet të rrisë kostot e jetesës dhe vulnerabilitetin e shtresave në nevojë. Kjo do të ndikojë jo pozitivisht të gjithë treguesit që lidhen me nivelin e jetesës, punësimin, të ardhurat, nga njëra anë, dhe do të rrisë nevojat për të siguruar një minimum të ardhurash për shtresat e varfëra në nevojë, nga ana tjetër.

3.1.2. Standardet ndërkombëtare, garancitë kushtetuese dhe ligjore për mbështetje sociale

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (OKB) parashikon (neni 1) se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta. Në nenin 22, kjo deklaratë parashikon se, si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti. Një nga parimet e Axfordës së Kombeve të Bashkuara 2030 është progresi drejt objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u kushtuar vëmendje të veçantë familjeve dhe individëve në nevojë.

Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁷, njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale.

Në mënyrë të ngjashme, Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale.

Dinjiteti dhe liria e njeriut janë vetë thelbi i KEDNJ⁸. Pa mohuar parimin e shenjtërisë së jetës të mbrojtur nga KEDNJ, GJEDNJ është e mendimit se nocioni i cilësisë së jetës e merr të gjithë domethënien e vet pikërisht në këndvështrimin e nenit 8 të KEDNJ.

Bazuar në nenin 52 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj dhe kushdo, kur mbetet pa punë për shkak të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj.

Në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.65, datë 10.12.1999, gjykata e ka konsideruar dinjitetin e njeriut, e bashkë me të edhe të drejtën për jetën,

7 Ligj nr.7511, datë 8.8.1991 "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore".

8 Ligji Nr. 8137/1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore".

“si burimi nga i cili rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera si të drejta themelore absolute”.

Gjykata Kushtetuese ka bërë dallimin ndërmjet të drejtave dhe lirive ekonomiko-sociale dhe objektivave socialë⁹. Përmbajtja e të drejtave social-ekonomike, që për nga natyra janë të drejta pozitive, duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t’u bërë aktiv e për t’u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar. Shteti, me qëllim garantimin e dinjitetit njerëzor, të një niveli të pranueshëm jetese, si dhe ruajtjen e interesave të të gjitha shtresave të shoqërisë, mund të ndryshojë mekanizmin e realizimit të këtyre të drejtave, veçanërisht kur nuk ka mundësi financiare për rishpërndarje proporcionale të fondeve në dispozicion, ose kur këto masa diktohen nga nevoja për të eliminuar apo parandaluar rreziqe reale ndaj sigurisë ekonomike. Në çdo rast, këto kufizime nuk duhet të cenojnë thelbin e së drejtës dhe duhet të respektojnë kërkesat kushtetuese të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës. Pra, në çdo rast, duke qenë se të drejtat social-ekonomike janë të drejta themelore, këto gëzojnë të gjitha garancitë kushtetuese, edhe pse ndryshimet ligjore që përkeqësojnë masën e përfitimit të tyre mund të diktohen nga kriza ekonomike apo mungesë fondesh. Sipas qëndrimit të konsoliduar të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese¹⁰, mbrojtja sociale sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë realizohet në dy forma: përmes të drejtave sociale dhe përmes objektivave socialë. Mbrojtja sociale realizohet edhe përmes përmbushjes së objektivave socialë që shteti synon të realizojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësive private. Midis të tjerash, ato përfshijnë edhe synimin për riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës. Kushtet dhe masa në të cilat mund të kërkohet realizimi i objektivave sociale i përket rezervës ligjore absolute, pra rregullimit me ligj të miratuar nga ligjvënësi¹¹.

Në përputhje me standardet kushtetuese dhe ndërkombëtare, e drejta për

9 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.34/2012.

10 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.33/2010 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.34/2012.

11 Paragraf 23 i Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.34/2012.

dinjitet njerëzor nënkupton një paketë të drejtash, mbrojtja e të cilave është e nevojshme në mënyrë që të ruhet dinjiteti i njeriut.

Në këtë kuadër, Qeveria Shqiptare bazuar në Strategjitë Kombëtare për Zhvillim dhe integrim dhe dokumentet politike për përfshirjen sociale, ka nisur një reformë të sistemit të mbrojtjes shoqërore duke investuar në hartimin e një legjislacioni të ri në këtë fushë dhe ndërtimin e mekanizmave për të siguruar një sistem efektiv të mbrojtjes sociale.

Korniza kryesore ligjore mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet pagesat e asistencës sociale përbëhet nga:

- Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

Ligjet e mësipërme shoqërohen me aktet nënligjore përkatëse të cilat përmbajnë dispozita zbatuese dhe synojnë zbatimin efektiv të ligjeve përkatëse.

Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale” ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si edhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të kësaj të drejte. Më tej, ky ligj përkufizon asistencën sociale, e cila përfshin por nuk kufizohet në, ndihmën ekonomike, pagesat e aftësisë së kufizuar, ndihmën e menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura dhe përfitimet e tjera që garantohen nga Ligji për Asistencën Sociale.

Ligji për Asistencën Sociale dhe aktet përkatëse nënligjore krijojnë bazën ligjore për mbështetjen financiare dhe përfitimet e tjera për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore. Ky legjislacion synon të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi mbështetjeje financiare, ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre, dhe

mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Bazuar në nenin 7¹² përfituesit e ndihmës ekonomike kategorizohen në

- a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;
- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
- d) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;
- e) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Ndërkohë neni 8¹³ parashikon përfituesit e Pagesës së Aftësisë së Kufizuar të cilët janë:

- a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë se janë bërë të tillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë;
- b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;
- c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
- d) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

Më tej, Ligji për Asistencën Sociale, në nenin 9, parashikon përfituesit e ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjën e sapolindur (bonus i

12 Ligji nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale"

13 Ligji nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale"

bebes). Ndërsa, neni 10 i ligjit parashikon për kategoritë e personave që përfitojnë ndihmës personal. Këto dy përfitime të fundit nuk janë në fokusin e këtij Raporti por, i përmendim për efekte qartësie për analizën e mëposhtme në lidhje me llojin e pagesave dhe përfitimeve sipas Ligjit për Asistencën Sociale e ligjet dhe aktet nënligjore kryesore të tjera përkatëse.

3.1.3. Mbrojtja sociale

- **Kuadri politik**

Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020 – 2023) integron masat për fuqizimin dhe mbështetjen e njerëzve që jetojnë në varfëri, personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, grave, të moshuarve, të rinjve, pakicave etnike dhe kategorive të tjera të cenueshme. Vizioni i përgjithshëm është ndërtimi i sistemit të mbrojtjes sociale për të luftuar pabarazitë socio-ekonomike me politika dhe mekanizma për të mbrojtur të gjithë individët vulnerabël ose të përjashtuar, përmes programeve parandaluese dhe riintegrit social të kombinuara me skemat e punësimit. Një nga politikat ku mbështetet strategjia e mbrojtjes sociale është zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër. Kjo politikë synon përmirësimin e shënjestrimit e tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e ndihmës ekonomike, si dhe lidhjen me skemat e punësimit, me shërbime të integruara me qëllim riintegrit social të tyre në jetën shoqërore. Më tej, kjo strategji ashtu si dhe Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore (2021-2030) dhe Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2025), ndajnë parimin askush të mos mbetet pas, duke qëndëruar barazinë, mbrojtjen e riintegritin e viktimave të e dhunës apo PAK.

- **Aktorët përgjegjës dhe rolet e tyre**

Qeveria qendrore ka përgjegjësinë për hartimin dhe mbikëqyrjen e politikave në fushën e mbrojtjes sociale, duke përfshirë ndihmën ekonomike, skemat e pensioneve dhe programet e punësimit. Mandatin për mbrojtjen sociale e ka

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) është përgjegjëse për sistemin e pensioneve dhe politikat e punësimit.

Shërbimi Social Shtetëror (SHSSH) është institucioni i ngarkuar me zbatimin e politikave, legjislacionit e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore në të gjithë vendin. Këtë mision e realizon nëpërmjet administrimit të shërbimeve shoqërore për individët në nivel kombëtar; programimit të fondeve të ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar; kontrollit të zbatimit të legjislacionit dhe përdorimit të fondeve buxhetore; administrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar për aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror si dhe monitorimit të standardeve të shërbimeve sociale në nivel kombëtar. Roli dhe përgjegjësitë e SHSSH kanë evoluar gradualisht nga një fokus në ofrimin e shërbimeve, në një rol mbikëqyrës, monitorues e mbështetës teknik për bashkitë, edhe pse ende ruan përgjegjësinë për ofrimin e disa shërbimeve në nivel kombëtar.

Pushteti vendor ka një sërë përgjegjësish lidhur me mbrojtjen sociale, nisur nga zbatimi i programeve për zbutjen e varfërisë (Ndihma Ekonomike) dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar; si dhe planifikimin, financimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social. Roli i qeverisjes vendore në menaxhimin e programit të ndihmës ekonomike është kthyer në atë të një agjenti pagesash për qeverinë qendrore. Administratorët shoqërorë nuk kanë më mbikëqyrje, as diskrecion në vendimmarrje mbi pranueshmërinë, e cila drejtohet përmes një sistemi të kompjuterizuar bazuar në një formulë vlerësimi relativisht jo transparente; as mbi masën e përfitimeve pas përcaktimit të përshtatshmërisë për të përfituar nga NE. Pushteti vendor, ka përgjegjësinë për të menaxhuar procesin e aplikimeve, si dhe ndjekjen e aplikantëve dhe/ose përfituesve përmes kontrolleve të verifikimit në familje. Reforma e skemës së pagesës së aftësisë së kufizuar, aktualisht duke u shtrirë gradualisht në tërë vendin deri në fund të 2022, pritet të pasqyrojë kryesisht të njëjtën ndarje të përgjegjësive si në rastin e programit të zbutjes së varfërisë.

Zbatimi i politikave të riintegritit përmes punësimit apo instrumenteve të ngjashme mbetet një sfidë. Vitet e fundit qeveria është angazhuar në politika të tregut të punës dhe arsimit profesional, me synimin për të forcuar lidhjet

midis ofertës dhe kërkesës si dhe për të mbështetur riintegrimin e individëve dhe familjeve në nevojë, përfitues të programeve të ndryshme të mbrojtjes sociale si NE apo PAK. Megjithatë lidhja mes politikave të mbrojtjes sociale dhe riintegritit është një sfidë duke qenë se janë role të ndara mes dy ministrive – Ministria e Financës dhe Ekonomisë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ministria e Arsimit nga ana tjetër menaxhon programe të vogla në mbështetje të arsimit gjithëpërfshirës, duke u fokusuar kryesisht në bursat në arsimin fillor, subvencionet për çmimin e teksteve në arsimin para universitar duke prioritetizuar individët dhe familjet në nevojë e përfitues të NE.

• Regjistrat Elektronike Kombëtarë

Skema e pagesave të mbrojtjes sociale zbatohet në praktikë nëpërmjet funksionimit të Regjistratit Elektronik Kombëtar të Ndhmës Ekonomike dhe Regjistratit Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar.

Bazuar në nenin 4 pika 'r' dhe 'rr'¹⁴ të Ligjit për Asistencën Sociale, me Regjistër Elektronik Kombëtar të NE kuptojmë bashkësinë e të dhënave të përfutuara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit të familjeve / individëve në nevojë për përfitim të NE; ndërsa me Regjistër Elektronik Kombëtar të Aftësisë së Kufizuar kuptojmë bashkësinë e të dhënave të përfutuara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të aftësisë së kufizuar gjatë procesit të aplikimit për vlerësim dhe përfitim të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Në nenin 20¹⁵ pika 3/b të Ligjit për Asistencën Sociale parashikohet se Shërbimi

14 Neni 4 'Perkufizime'

"... r) "Regjistri elektronik kombëtar i ndihmës ekonomike", është bashkësia e të dhënave të përfutuara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të ndihmës ekonomike gjatë procesit të aplikimit të familjeve/individëve në nevojë për përfitim të ndihmës ekonomike;

rr) "Regjistri elektronik kombëtar i aftësisë së kufizuar", është bashkësia e të dhënave të përfutuara nga sistemi i menaxhimit të informacionit të aftësisë së kufizuar gjatë procesit të aplikimit për vlerësim dhe përfitim të aftësisë së kufizuar;..."

15 Neni 20 'Roli i Shërbimit Social Shtetëror' i Ligjit për Asistencën Sociale:

"3. Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, përgjigjet për zbatimin e politikave të asistencës sociale të Ministrisë përgjegjëse për Çështjet sociale, si më poshtë:

b) administrimin dhe përdorimin e të dhënave të Regjistratit Elektronik Kombëtar, i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar;

4. Shërbimi Social Shtetëror në nivel rajonal, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë

Social Shtetëror në nivel qendror e rajonal përgjigjet për zbatimin e politikave të asistencës sociale edhe për administrimin dhe përdorimin e të dhënave të Regjistrin Elektronik Kombëtar i cili përfshin aplikantët dhe përfituesit e ndihmës ekonomike dhe të pagesës së aftësisë së kufizuar. Më tej, Shërbimi Social Shtetëror ka për detyrë në bazë të pikës 4/a të nenit 20 të Ligjit për Asistencën Sociale të verifikojë të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për individët/familjet në nevojë në Regjistrin Kombëtar Elektronik dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse.

Neni 23¹⁶ i Ligjit për Asistencën Sociale parashikon rolin e administratorit shoqëror edhe në lidhje me plotësimin e aplikimit për individët dhe familjet në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar.

Në nenet e sipërpermendura të Ligjit për Asistencën Sociale përveçse kuptojmë rolin dhe përgjegjësitë e strukturave të mësipërme në lidhje me Regjistrin Kombëtar Elektronik, kuptojmë që Regjistri Elektronik Kombëtar i NE dhe Regjistri Elektronik Kombëtar i Aftësisë së Kufizuar përbëjnë një regjistër të vetëm të integruar (pra, Regjistrin Elektronik Kombëtar) të ndërtuar mbi llogjikën e pagesave të ndryshme të skemës së asistencës sociale në Republikën e Shqipërisë.

Në kuptimin ligjor, regjistrat elektronikë janë mjete që i shërbejnë zbatimit në praktikë të legjislacionit përkatës dhe të cilat duhet të ndërtohen në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës të miratuar. Monitorimi i përputhshmërisë

në Regjistrin Kombëtar Elektronik dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse;

ç) grumbullon dhe përgatit informacione e statistika, të cilat i dërgon pranë strukturave rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, mban regjistrin e përfituesve dhe ndjek shpenzimet për ndihmën ekonomike, pagesën e personave me aftësi të kufizuar;..”

16 Neni 23 ‘Roli i administratorit shoqëror të njësisë administrative’:

Administratorët shoqërorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë:

“... b) të plotësojnë aplikimin për familjet dhe individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar;

ç) të paraqesin pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike.”

Neni 22 ‘Roli i strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki’:

“Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, për efekt të ndihmës ekonomike dhe pagesave të aftësisë së kufizuar, kryen këto detyra:

“a) dërgon nëpërmjet Regjistrin Elektronik Kombëtar listën e plotë të familjeve/individëve në nevojë nën juridiksionin e bashkisë pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror për trajtim me ndihmë ekonomike;”

së përcaktimit të tipareve të regjistrave elektronikë (Regjistrit Elektronik Kombëtar) me dispozitat përkatëse ligjore siguron potencial për zbatimin efektiv të ligjit në fushën përkatëse, në këtë rast, në lidhje me Asistencën Sociale.

- **Programet e Ndhmës Ekonomike, PAK dhe kategoritë e veçanta**

Ndihma ekonomike përbën mbështetjen në para që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë. Kjo ndihmë i jepet një herë në muaj familjeve dhe individëve në nevojë dhe kategorive në nevojë të përcaktuara si të tilla në legjislacionin që rregullon asistencën sociale (Ligj Nr. 57/2019). Masa e NE përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave (VKM Nr. 597/2019). Masa e ndihmës ekonomike reflekton strukturën e familjes dhe shkon deri në 150% të masës së pensionit social dhe e indeksuar. Skema bazohet në një vlerësim të testimit të mjeteve dhe burimeve (Proxy Means Tested) dhe familjet mund të jenë përfitues edhe nëse kanë disa burime të ardhurash. Programi gjithashtu parashikon pagesa shtesë që lidhen me fëmijët që ndjekin arsimin fillor dhe prindërit që vaksinonjë fëmijët e tyre; (300 lekë në muaj për çdo fëmijë që ndjek arsimin e detyrueshëm dhe 100 lekë për vaksinimin).

Që nga shtrirja e programit të reformuar të ndihmës ekonomike në vitin 2018, numri i familjeve të varfra që përfitojnë nga programi ka qenë në rritje nga një mesatare mujore prej 54,299 familjeve të varfra në 2018 në 60,496 në 2019, 61,445 në 2020. Numri i individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike në vitin 2020 raportohet të jetë 263,101 persona. Në projekt-buxhetin e vitit 2022, qeveria parashikon që përfituese të NE të jenë rreth 66,000 familje. Familjet me 4 anëtarë përbëjnë 33.8% të totalit, ndjekur nga 22.3% që janë familje me 5 anëtarë, dhe 19.1% familje me tri anëtarë. Masa e ndihmës ekonomike për këto familje është respektivisht: 5,078 lekë në muaj; për familjet me 4 anëtarë; për familjet me 5 anëtarë rreth 5,670 lekë; ndërsa për familjet me 3 anëtarë NE është 4,099 lekë në muaj. Mesatarja e NE, për vitin 2020 është 5,161 lekë¹⁷.

Tabela 2: Numri mesatar i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike dhe masa mesatare mujore

	2018	2019	2020	2021
Numri i familjeve që përfitojnë NE	54,299	60,496	61,445	63,859
Masa mesatare mujore e perfitimit të ndihmës ekonomike për një familje*	5,137	5,225	5,161	9,189

Burimi: SHSSH

Shënim*: mesataret e kalkuluara mbi të dhënat e marra nga INSTAT <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/mbrojtja-sociale/#tab2>

Pjesë e asistencës sociale janë dhe përfitimet e aftësisë së kufizuar, transfertat “cash” që adresojnë personat me aftësi të kufizuara dhe, në rastet e paaftësisë së plotë, kujdestarët e tyre si dhe familjet në nevojë. Tashmë, MSHMS po vijon zbatimin e një reforme të gjerë të kësaj skeme, e cila synon aplikimin e vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar, decentralizimin e procesin e vendimmarrjes si dhe diferencimin e përfitimeve në para në përputhje me shkallën e funksionalitetit të individit. Reforma e cila fillimisht u pilotua në Tiranë për dy vjet, prej shtatorit të vitit 2021, u shtri në qarqet Durrës dhe Elbasan e, prej muajit janar 2022, do të nisë zbatimin në katër qarqe të tjera, konkretisht, në Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë, duke shtrirë kështu gradualisht zbatimin në të gjithë vendin deri në fund të vitit 2022.

Përfitimet ‘cash’ për aftësinë e kufizuar arrijnë në maksimum 10,653 lekë, të cilat janë nën pragun AROPE prej 14,648 lekë.

Numri i Personave me Aftësi të Kufizuar, të përfshirë në programin e mbështetjes ndaj tyre regjistron një rritje graduale kumulative prej 5% gjatë tri viteve të fundit, nga 67,669 përfitues në vitin 2018 në rreth 71,147 përfitues të pagesave për AK në fund të Gushtit 2021 (SHSSH, 2021). Këto shifra nuk përfshijnë kategorinë e invalidëve të punës.

Situata e dhunës në familje dhe urdhrat e mbrojtjes. Gjatë vitit 2019 janë identifikuar dhe proceduar 4,629 raste të dhunës në familje në vitin 2019 dhe 4,701 raste në vitin 2020. Në vitin 2019 janë lëshuar 2,834 urdhra mbrojtjeje kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje dhe 2,816 urdhra mbrojtjeje të lëshuara per periudhën 2020. Ndërkohë që dhuna psikologjike, sikurse u

shprehën dhe grupet e interesit, nuk raportohet. Të dhënat administrative tregojnë së vetëm një pjesë e vogël e rasteve me urdhër mbrojtjeje rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike. Tabela e mëposhtme përmbledh numrin dhe peshën që zënë përfituesit sipas kategorive të veçanta, për vitin 2019 dhe 2020 dhe masën përkatëse të përfitimit.

Tabela 3. Kategoritë e veçanta përfituese të ndihmës ekonomike dhe masa e përfitimit

	Viktimë Dhune	Viktimë Trafikimi	Fëmijë me aftësi të kufizuar në kujdestari	Fëmije në kujdestari të një familje kujdestare	Jetimët që nuk janë në institucione	Trinjakë, katërnjakë, pesënjakë
Nr. Mesatar i përfituesve (2019)	456 (29%)	9 (0.6%)	11 (0.7%)	348 (22%)	642 (41%)	98 (6%)
Nr. Mesatar i përfituesve (2020)	528 (32%)	10 (1%)	15 (1%)	359 (22%)	628 (38%)	93 (6%)
Masa e përfitimit	3,000 lekë në muaj	3,000 lekë në muaj	10 000 lekë në muaj	9,000 lekë në muaj + 25,000 lekë në vit për fëmijët në arsim	3,000 lekë në muaj	Trinjakë: 3,000 lekë) Katërnjakë: 4,000 lekë Pesënjakë: 5,000 lekë

Burimi: SHSSH, 2021

Përfituesit që u përkasin kategorive të veçanta përfaqësojnë vetëm 2% të totalit të numrit mesatar të përfituesve të ndihmës ekonomike gjatë viteve 2019 dhe 2020. Mesatarisht për vitin 2019 rreth 1,563 përfitues i përkasin kategorive të veçanta dhe në vitin 2020 ky numër është 1,631, ndërsa viktimat e dhunës në familje përfaqësojnë vetëm 1% të totalit të përfituesve të programit të ndihmës ekonomike përkatësisht për çdo vit. E shprehur ndryshe, në totalin e vet, kategoria e viktimave të dhunës në familje përfaqëson rreth 0.2% të personave që përfitojnë NE në të gjithë Shqipërinë, ndërsa masa monetare llogaritet të jetë rreth 0.5% e fondit total të ndihmës ekonomike për vitin 2020. Për bashkinë Tiranë numri i viktimave të dhunës për vitet 2019 dhe 2020 është

respektivisht 103 dhe 108 persona - këto përfaqësojnë respektivisht 3.9% dhe 4% të numrit total të përfituesve të NE dhe kategorive të veçanta në bashkinë Tiranë; për të njëjtën periudhë në bashkinë Korçë viktimat e dhunës janë 3 dhe 6 persona - ose respektivisht 0.5% dhe 0.8% e totalit të përfituesve në këtë bashki; ndërsa për bashkinë Mat janë respektivisht 5 dhe 3 viktima të dhunës në familje - që përfaqësojnë respektivisht 0.3% dhe 0.2% të totalit të përfituesve për bashkinë e Matit (SHSSH, 2021).

Siç vërehet, jetimët që nuk janë në institucione janë grupi kryesor përfitues si kategori e veçantë (41% për vitin 2019 dhe 38% për vitin 2020), ndjekur nga viktimat e dhunës në familje (29% për vitin 2019 dhe 32% për vitin 2020) dhe fëmijët në kujdestari (22% për të dy vitet). Kategoritë e tjera përfshijnë fëmijët me aftësi të kufizuara në kujdestari (0.7-1%), viktimat e trafikimit (0.6-1%) si dhe trinjakët e më shumë (6%).

Pagesa e përfituar nga viktimat e dhunës në familje është në masën 3,000 lekë në muaj; përkufizohet nga aktet nënligjore dhe jepet për gjithë periudhën e vlefshmërisë së Urdhrit të Mbrojtjes (VKM Nr. 597/2019). Në vlerë absolute fondi i alokuar për të përballuar pagesat për viktimat e dhunës në familje në vitin 2020 është 19,188,000 lekë, ose 0.35% e fondit për NE për të njëjtin vit, ndërsa në vitin 2019 ky fond është në rendin e 16,704,000 lekë (SHSSH, 2021) ose 0.39% e fondit të alokuar për NE në të njëjtin vit.

- **Përfitime të tjera shtesë për kategori të veçanta**

Legjislacioni parashikon se personat që kanë statusin e të verbërit¹⁸ përjashtohen nga çfarëdolloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur ata kryejnë veprimtari private si persona juridik, përfitojnë arsimim falas dhe gjatë kohës së studimit përfitojnë pagesën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkencore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme, përfitojnë sigurimin shëndetësor, përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, përfitojnë kompensim për transport urban dhe me gjysmë çmimi në transport interurban, duke përfshirë atë shtetëror

18

Ligji nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për Statusin e të Verbërit", i ndryshuar

dhe privat¹⁹. Personat që kanë statusin e të verbërit përfitojnë kompensim për konsumin mujor të energjisë elektrike dhe ndryshimin e çmimit të energjisë elektrike (paguhen nga shteti), dhe përfitojnë hyrjen falas në mjediset kulturore.

Legjislacioni parashikon se **personat që kanë statusin e invalidit**²⁰ përjashtohen nga taksat doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të tyre, përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta të parashikuara në ligjin nr. 7680, datë 03.03.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”. Ata favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional si dhe ndjekjen e shkollave të larta si dhe përfitojnë shërbim mjekësor në banesë falas. Personat që kanë statusin e invalidit përfitojnë udhëtimin me mjetet e transportit shtetëror dhe atij privat falas dhe udhëtimin ndërqytetës e përfitojnë 50% të vlerës së biletës. Gjithashtu, përfitojnë hyrjen në mjediset kulturore, shfaqje artistike, muze ndeshje me 50% të çmimit të biletës.

Legjislacioni parashikon se personat që kanë statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik²¹ përjashtohen nga taksat doganore për mjetet lëvizëse dhe ndihmëse të tyre dhe përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta. Ata favorizohen në ndjekjen e arsimimit, përjashtohen nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe kanë të drejtën e përfitimit falas të barnave nga skema e sigurimeve shoqërore, si dhe përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare, e përfitojnë shërbimin në banesë nga mjeku i familjes dhe mjeku specialist për ato procedura që mund të kryhen në mënyrë ambulatorie. Personat me statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit, kompensim të konsumit mujor të energjisë elektrike dhe ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse, si dhe kanë përparësi në trajtimin me strehim, nëpërmjet kredive të dhëna me kushte lehtësuese.

Personat me aftësi të kufizuara (PAK) të cilët nuk përfshihen në grupet e mësipërme (pra, që nuk kanë përfitime për shkak të statusit të veçantë)

19 Për mungesën e miratimit të akteve nënligjore në lidhje me transportin, KMD ka lëshuar rekomandime për institucionet përgjegjëse.

20 Ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidit”, i ndryshuar.

21 Ligji nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar.

gëzojnë përfitimet përkatëse të parashikuara nga Ligji për Asistencën Sociale dhe përfitimet si më poshtë:

Familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike përfitojnë kompensimin e diferencës së çmimit të energjisë elektrike sipas VKM nr.8, datë 14.1.2015 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj”, në masën 648 lekë në muaj. Efekti financiar i këtij kompensimi përballohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Për familjet në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike, administratori shoqëror i njësisë së qeverisjes vendore harton listën emërore të personave që përfitojnë këtë kompensim²² dhe aplikanti së bashku me deklaratën, duhet të paraqesë pranë administratorit shoqëror, midis të tjerave edhe certifikatën familjare.

Më tej, legjislacioni në fuqi parashikon se një viktimë e dhunës në familje e cila përfiton ndihmë ekonomike si kategori e veçantë, por përjashtohet nga përfitimi i NE si individ/pjesëtar i familjes në nevojë, do të përfitojë kompensim të energjisë elektrike sipas akteve përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar në VKM nr.565, datë 9.8.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar. Kompensimi për familjet, bëhet vetëm për një kontratë të energjisë elektrike dhe jepet vetëm një herë për një familje, pavarësisht se ato mund të kenë në përbërje edhe të punësuar të tjerë në sektorin buxhetor, që kanë pagë nën 35,000 lekë, apo persona me aftësi të kufizuara, anëtarë që përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo ndihmë ekonomike. Bazuar në Udhëzimin nr.10, datë 26.09.2006 “Për zbatimin e VKM nr.565, datë 9.8.2006 “Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike²³”, administratori shoqëror i njësisë vendore harton listën emërore të personave që përfitojnë këtë kompensim. Personat duhet të deklarojnë, midis të tjerave, edhe nëse personi që kërkon kompensim është kryefamiljar dhe përfiton nga skema e ndihmës ekonomike, nëse ka apo jo në përbërje të saj anëtar që përfiton pagesë për aftësi të kufizuara ose invaliditet pune. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, kompensimi i familjes, bëhet vetëm një herë dhe e merr kryefamiljari që përfiton ndihmën ekonomike.

22 Sipas skemës ekzistuese përkatëse, personat me status të veçantë (të verbër, paraplegjikë dhe tetraplegjikë), përfitojnë kompensim energjie 1400 lekë/muaj nëse nuk kanë nevojë për kujdestar ose 2000 lekë/muaj nëse kanë nevojë për kujdestar (VKM 404/20.06.2012).

23 Shuma 500 lekë/muaj për kompensim çmimi është ndryshuar në 640 lekë/muaj.

Pagesat e ndihmës ekonomike për kategoritë e parashikuara në ligj, me vëmendje të veçantë për viktimat e dhunës në familje, bazuar në VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në pikën 13, Kreu II, parashikon se pagesat do të paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njësive administrative ku ka vendbanimin²⁴ përfituesi. Njësia administrative, me kërkesë të qytetarit, e pajis atë me dokumentin që vërteton se trajtohet me NE, duke përcaktuar masën e përfitimit dhe periudhën e trajtimit. Po kështu, bazuar në pikën 4.1, Kreut II, VKM nr.597/2019, subjektet e përcaktuara mund të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin duke paraqitur dhe dokumentet e kërkuara nga ligji.

3.2. Adresimi i varfërisë përmes ndihmës ekonomike dhe zbatimi në praktikë

- Informacioni dhe aksesimi

Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm. Mungon një qasjeje e njëjtë për ndarjen e informacionit me publikun përmes institucioneve që ofrojnë shërbime e sportelet që aksesohen më shpesh nga kategoritë në nevojë. “Kryesisht prezantohen shërbimet që ofrojmë vetë e harrohet të prezantohen programet e tjera që mund të aksesojnë. Mungesa e informacionit çon dhe në mungese aksesimi” shprehen përfaqësuesit e OJFve. Ka raste kur një viktimë e dhunës në familje paraqitet në strehëzat e specializuara edhe pse ka UM

24 Për të përkufizuar termin e “vendbanimit”, bazuar në nenin 14 të ligjit nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” gjejmë të shprehur se: 1. Shtetasit kanë të drejtë të kenë një apo më shumë banesa për përdorim vetjak apofamiljar në territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë vendit. Shtetasit kanë detyrimin që të deklarojnë adresën e çdo banese për përdorim, sipas kësaj pike.2. Shtetasit kanë të drejtë të zgjedhin lirisht në cilën banesë të jetojnë zakonisht ose të shumtën e kohës. Banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tremuj pandërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij.

por nuk marrin NE sepse nuk kanë patur informacion. Si pasojë, nga mungesa e informacionit kanë humbur deri në tri muaj nga përfitimi i mundshëm i ndihmës ekonomike. “Duket sikur fokusi ka kaluar nga ndërgjegjësimi për dhunën në nevojën për informim mbi të drejtat dhe shërbimet, e, edhe pas kaq vitesh, ka ende mjaft për të bërë për informimin që duhet të jetë hapi i parë.” – përfaqësues të OJFve.

Informacioni i pamjaftueshëm u konfirmua dhe nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, pranë Ministrisë së Drejtësisë, duke përfshirë dhe mendimet e dhjetë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në bashki të ndryshme të vendit.²⁵ Konkretisht, sipas tyre informacioni mbi mënyrën e përfitimit të pagesës si viktimë e dhunës nga qytetarët rezultoi të jetë i cunguar, në kuptimin që njihet mundësia për të përfituar këtë pagesë, por që nuk kanë informacion mbi mënyrën si mund ta përfitojnë, te cilat institucione duhet të drejtohen, sa është masa e pagesës, si dhe afatin për përfitimin e kësaj pagese. Duke pasur parasysh këto kufizime, shpesh herë qytetarët paraqiten pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore për të marrë informacion dhe orientohen nga punonjësit sesi duhet të veprojnë. Ashtu si OJFtë dhe përfaqësuesit e qendrave të ndihmës juridike, shprehen se ka patur raste kur qytetarët nuk kanë pasur dijeni që ekzistonte një pagesë e tillë. Kryesisht, informacioni mbi përfitimet merret përmes policisë, gjykatave dhe pononjësve socialë në bashki dhe, më pak, nga zyrat e ndihmës juridike apo struktura të tjera.

Kategoritë e veçanta nuk kanë informacion që mund të përfitojnë mbështetje si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë. Ka raste kur administratorët shoqërorë kërkojnë të paraqiten të dy bashkëshortët në aplikim si familje në nevojë edhe pse aplikantja është me urdhër mbrojtjeje e ka një procedurë të zgjidhjes së martesës në proces.

Familjet e individët në nevojë që banojnë në njësitë e largëta e me terren të vështirë hasin vështirësi për të aplikuar për NE, si pasojë e mungesës së një transporti publik funksional të shtrirë në zonat rurale dhe pamundësisë për të mbuluar kostot e transportit privatisht. Nënshkrimi i deklaratës 3 mujore është gjithashtu një moment tjetër kur pamundësia për t’u paraqitur i përjashton

25 Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, pranë Ministrisë së Drejtësisë, në mbështetje të hulumtimit, validoi me dhjetë Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në bashki të ndryshme të vendit disa nga çështjet kryesore në fokus të studimit.

përfituesit si kategori në nevojë nga sistemi i NE.

Forcimi i kapaciteteve të njësive administrative dhe aktorëve pjesë e mekanizmit referues do të shërbente për garantimin e zbatueshmërinë e kuadrit ligjor dhe ofrimin e informacionit për kategoritë në nevojë. “Administratorët mund të bëjnë dëme në plotësimin e aplikimit si pasojë e mungesës së informacionit, ndërkohë që mungon kultura e leximit të formularit të plotësuar nga ana e aplikantëve përpara firmosjes” – shprehen administratorët shoqërorë në Bashkitë Tiranë e Pogradec.

Nevoja për forcim kapacitetesh u theksua dhe nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe dhjetë Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore. Sipas tyre, të gjithë punonjësit me trajnim të posaçëm pranë Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore rezultojnë se kanë informacion të përgjithshëm, por kanë nevojë për trajnime specifike mbi procedurën e aplikimit e përfitimit të kësaj të drejte.

• Aplikimi dhe përfitimi i NE

Vetëm kategoritë familje në nevojë mbulohe përmes fondit shtesë prej 6% të administruar nga bashkitë – pra ky fond nuk shërben si mekanizëm për të adresuar nevojën emergjente të viktimave të dhunës në familje. Në rastin e Bashkisë Korçë, përmes këtij fondi është arritur trajtimi i familjeve fëmijët e të cilëve konsumojnë substanca narkotike e si pasojë, janë kthyer në familje në nevojë. Sikurse u konfirmua dhe nga intervistat, skema aktuale nuk i mbulon këto kategori, të cilat mund të kenë tregues të ndryshëm vulnerabiliteti.

Në praktikë kemi konstatuar se për aplikime të veçanta nuk zbatohet parimi i mbizotërimit të dispozitave ligjore dhe i krijimit të praktikave ligjore sipas dispozitave ligjore përkatëse të publikuara në Fletoren Zyrtare. **Administratori shoqëror ka diskrecion në hedhjen e të dhënave gjatë plotësimit të aplikimeve për individë / pjesëtar të familjeve në nevojë.**

Për viktimat e dhunës që janë larguar në një bashki tjetër, aplikimi pranë bashkisë së origjinës, ku figurojnë të regjistruar, është një barrierë që hasin për t’iu qasur mbështetjes si për nga aksesin (p.sh. distanca, kosto transporti) dhe nga frika prej dhunuesit.

Personat që janë strehuar në strehëza, nuk mund të përfitojnë ndihmë ekonomike gjatë kohës që trajtohen në këto institucione të përkujdesit publike, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit (Ligji 57/2019).. Strehëzat, publike apo jo publike, kanë burime të kufizuara e, përveç shërbime, mund të mbulojnë vetëm nevojat më bazike të rezidentëve . Përfaqësuesit e OJF-ve u shprehen se për shkak të pasigurisë në interpretimin e ligjit (57/2019, neni 11, pika ‘dh’), disa prej tyre nuk deklarojnë gjatë referimit se viktimat e dhunës ndodhet në strehëz për të mundësuar përfitimin e ndihmës ekonomike, në kushtet që ligji shprehimisht parashikon që personat të cilët trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit nuk përfitojnë për masën e ndihmës ekonomike apo PAK. Sikurse u shprehen dhe përfaqësuesit e OJF-ve, duke patur parasysh që kategoria që paraqitet në institucionet e përkujdesit rezidencial ka probleme më shumë se sa vetëm dhunën, duhet të rishikohet kufizimi i përfitimit të ndihmës ekonomike për viktimat e dhunës në familje në strehëza.

- **Sfida që lidhen me Urdhrat e Mbrojtjes**

Varësia e përfitimit të NE nga Urdhri i Mbrojtjes (UM) shkakton vonesa të konsiderueshme për marrjen e përfitimit. Viktima e Dhunës në Familje duhet të presë urdhrin e mbrojtjes për të aplikuar si kategori e veçantë. Në bashki më të mëdha, apo dhe bashki të tjera, ka më shumë ngarkesë në gjykatën e rrethit (shembulli i Tiranës, Shkodrës, Lezhës, Elbasanit e Vlorës).

Kjo edhe për shkak të pezullimeve si pasojë e procesit të vetingut, duke sjelle vonesa në zbardhjen e vendimeve që shkojnë deri në tre muaj, e ka raste edhe më shumë. Për viktimat e dhunës në familje kjo përbën një sfidë duke patur parasysh që urdhri i mbrojtjes ka një vlefshmëri mesatare gjashtë mujore e deri në një vjeçare. Ndikimi i vonesave me UM bëhet edhe më i rëndësishëm në rastet kur vlefshmëria e urdhrin të mbrojtjes është dy apo tre mujore.

Urdhri i Menjëhershëm i Mbrojtjes (UMM) nuk njihet nga administratorët shoqërorë si dokument i vlefshëm për të nisur procesin e aplikimit për NE - gjetje që është konfirmuar dhe nga organizatat e shoqërisë civile të cilat e kanë shtrirë aktivitetin e tyre në disa bashki të vendit. Në rastin e Bashkisë Korçë e Pogradec UMM mundëson nisjen e procesit të aplikimit për NE, ndërkohë që UM zbardhet brenda pak ditësh nga nxjerrja e UMM e nuk janë

evidentuar vonesa të ndjeshme. Në rastet e bashkive të tjera mungesa e UM është një pengesë për të realizuar aplikimin. Administratorët shoqërorë ndihen më të sigurt të vijojnë procesin e aplikimit në sistem me UM, pasi sipas tyre ka raste kur viktimat tërhiqet.

Vonesa në përfitimin si pasojë e kufizimit për të aplikuar brenda dhjetë ditëshit të parë të muajit; ndërkohë që sistemi nuk ofron fleksibilitet për të adresuar raste emergjente që i përkasin kategorive të veçanta. Kur paraqiten pas datës 10, duhet të presin muajin tjetër për të aplikuar, duke rezultuar në vonesa në aplikimin e përfitimit e NE.

Një sfidë tjetër që kanë hasur viktimat e dhunës në familje lidhet me përfitimin e ndihmës juridike falas. Konkretisht, kjo kategori nuk përfituan ndihmën juridike detyësorengagjykataskategorieveçantë në momentin që aplikantët nuk disponon një urdhër mbrojtje. Një problem tjetër mbetet tërheqja nga procesi gjyqësor.²⁶

- **Pagesat paralele**

Aplikimi i pagesave paralele nuk është i njëjtë në shumë bashki të vendit për të dy kategoritë në fokus. Janë identifikuar dy praktika kryesore të administratorëve shoqërorë.

Njëra praktikë është kur aplikantëve të ndihmës ekonomike, kryesisht viktimave të dhunës në familje, si pasojë e mungesës së kuptimit të qartë të praktikës, administratorët shoqërorë u ofrojnë të zgjedhin programin nga i cili dëshirojnë të përfitojnë, edhe pse nuk ka kufizime ligjore për të shkuar drejt një praktike të tillë. Ka mjaft raste kur aplikantët zgjedhin vetëm përfitimin si familje në nevojë, duke menduar që është më afatgjatë, pra përtej vlefshmërisë së UM. Me rritjen e masës së përfitimit si kategori e veçantë, ndoshta dhe sjellja e aplikantëve mund të ndryshojë nëse praktika e pagesave paralele nuk rregullohet.

Praktika e dytë lidhet me zbritjen e masës së ndihmës në rastet kur aplikanti është përfitues i masës së ndihmës si kategori e veçantë. Konkretisht, përveç Bashkisë Korçë, në rastin e pagesave paralele zbritet nga ndihma ekonomike masa e pagesës për individin përfitues si kategori e veçantë apo si PAK; edhe

26 Burimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, 2021.

pse të dy masat trajtojnë dy situata krejt të ndryshme e një vulnerabilitet të shumëfishtë të këtyre individëve e familjeve të tyre. Në rastin e pagesave të trefishta, si për shembull kur aplikanti është përfitues në skemën e aftësisë së kufizuar, e është dhe viktimë e dhunës dhe familje në nevojë – situata paraqitet edhe më e komplikuar e ka mungesë informacioni se si duhet vepruar. “Nuk më lejon sistemi” – është arsyeimi më i shpeshtë i administratorëve shoqërorë lidhur me ofrimin e pagesës paralele që u takon ligjërisht kategorive në fokus.

Një arsyetim tjetër i ndeshur gjatë intervistave ishte që të dy trajtimet e ofruara përmes programit të mbështetjes në para të ndihmës ekonomike – qoftë për kategoritë e veçanta, në këtë rast si viktimë e dhunës në familje, dhe si familje në nevojë, shënjestrojnë varfërinë me fokus në familjen e individin në nevojë, ndaj i njëjti individ nuk mund të përfitojë dy pagesa paralele nga i njëjti sistem, për të njëjtin qëllim.

Arsyetimi dhe praktikat janë kufizuese e bien ndesh me adresimin e vulnerabiliteteve të shumëfishta të individëve dhe familjeve duke njohur situatat e ndryshme të tyre që i bën këta individë edhe më vulnerabël (si p.sh. viktimë e dhunës në familje apo edhe PAK edhe familje në nevojë). Vulnerabilitetet e shumëfishta kërkojnë një qasje përfshirëse përmes programit të mbrojtjes (pra edhe) jo kufizuese apo përjashtuese.

Në kushtet e pasigurisë të interpretimit të qartë ligjor, zbatimi i programeve të mbrojtjes duket se udhëhiqet nga praktika më e shpeshtë e shqetësimi që praktika e ndjekur të mos përbëjë shkelje lidhur me përfitimet e ndryshme për kategoritë e veçanta dhe ato në nevojë. Këto praktika nuk udhëhiqen nga parimi mbi të cilin është hartuar programi i ndihmës ekonomike e nga parimi i respektimit të të drejtave të individëve me vulnerabilitete të shumëfishta. “Nëse nuk është e shkruar, mbetet në vullnetin e gjykimin e administratorit shoqëror” – përfaqësues i grupeve të interesit.

Më tej, kërkesat për pagesa paralele kërkojnë kryesisht nga vetë individët dhe, më pak prezantohen si mundësi mbështetjeje nga përfaqësuesit e tyre të autorizuar (ofruar shërbimesh, avokatë të ndihmës ligjore, etj), çka thekson nevojën për ofrimin e informacionit nëpërmjet hallkave të ndryshme të sistemit.

Nuk ka të dhëna të mjaftueshme nëse në praktikë, a vlerësohet paraprakisht nëse ndalimi i pagesave paralele **garanton apo cënon të drejtat dhe**

standardet përkatëse kushtetuese dhe ndërkombëtare²⁷, si e drejta për jetë dinjitoze e individit, etj., apo strukturat përkatëse ndalojnë pagesat pasi kështu interpretojnë dispozitat ligjore pa konsideruar të drejtat dhe garancitë kushtetuese të cilat mbizotërojnë në sistemin tonë juridik.

Administratorët shoqërorë shprehen se sistemi (Regjistri Elektronik Kombëtar) nuk i lejon të përfundojnë aplikimin e viktimave të dhunës në familje bazuar në Urdhrin e Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Viktima e dhunës në familje mund të aplikojë si familje në nevojë vetëm nëse është në procedurë të zgjidhjes së martesës; ndërkohë detyrimi i pagesës për shërbimin e psikologut në nisjen e procedurës së zgjidhjes së martesës është një kosto e konsiderueshme për këtë kategori. Procesi dhe kostot lidhur me zgjidhjen e martesës dhe pasiguria për realizimin e një jetese të pavarur kthehen në faktorë ndikues që çojnë në tërheqjen e viktimës së dhunës nga procesi dhe rikthimin në banesë e në ciklin e dhunës. Mungesa e gjyqtarëve ka sjellë zgjatjen e procesit të zgjidhjes së martesës deri në një vit e më shumë në disa bashki (Tiranë, Elbasan, Shkodër e Vlorë), duke shtuar sfidën për riintegrim social e aksesin në shërbime. Pagesa e detyrimeve ushqimore pas **zgjidhjes së martesës** në 80% të rasteve nuk paguhet nga bashkëshortët çka rrit barrën e nënave që janë dhe viktima të dhunës në familje.

Masa e ndihmës ekonomike si kategori e veçantë, viktimë e dhunës në familje, shpesh ofrohet për të gjithë pavarësisht nevojës. Administratorët shoqërorë ngritën shqetësimin se jo të gjithë tërheqin masën e ndihmës që u takon si kategori e veçantë. Sikurse u shprehën administratorët shoqërorë e aktorë të tjerë kyç, konfuziteti buron nga fakti që nuk është shprehur qartësisht në ligjin për asistencën sociale se mbështetja financiare për kategoritë e veçanta adreson specifikisht vetëm individët në nevojë. Si pasojë administratorët shoqërorë, me marrjen e UM nga gjykata, bëjnë në aplikimin në sistem në emër të viktimës së dhunës në familje pa praninë e saj duke e nxjerrë përfituese, ose pa verifikuar gjendjen socio-ekonomike të aplikantit. Kjo, sipas burimeve të ndryshme, ka rezultuar që të kualifikohen si përfitues jo detyrimisht individë në nevojë si mjekë apo nëpunës bankash. Më tej, mbetet në ndërgjegjen e tyre të tërheqin ose jo përfitimin edhe pse mund të mos kenë nevojë për këtë ndihmë ekonomike. Nga ana tjetër, ky arsyetim i përfitimit

27 Bazuar në KEDNJ, etj.

përtej nevojës, bie ndesh me logjikën që ndiqet për të aplikuar kufizimet apo përjashtimet nga pagesat paralele në sistem për kategoritë në nevojë. Mbi të gjitha, kjo gjetje thekson faktin që ka një kuptim jo të drejtë apo të njëjtë nga administratorët shoqërorë lidhur me përcaktimet ligjore mbi pranueshmërinë në sistemin e pagesave cash të mbrojtjes sociale për kategoritë në nevojë, përfshirë kategoritë e veçanta.

Barra e vërtetimit të situatës si kategori në nevojë i bie qytetarëve, çka kthehet në kosto në momentin që kërkojnë mbështetje juridike falas; pra sistemi kthehet në një qark vicioz në momentin kur duhet të aktivizojë planet e mbështetjes konkrete. Me poshtë janë përmbledhur tipologjitë kryesore të dokumentacionit të nevojshëm dhe kostot përkatëse²⁸:

- o Vërtetimi i papunësisë apo vërtetimi i pagës (lëshohet pa pagesë);
- o Vërtetim për llojin dhe masën e pensionit (lëshohet pa pagesë);
- o Çertifikatat familjare dhe çertifikatat e tjera merren falas dhe gjenerohen nga portali individual i qytetarit në e-albania ose pranë ADISA;
- o Vërtetimi që nuk ka prona nga ASHK, kundrejt pagesës në vlerën 500 lekë;
- o Shërbimi postar 200 lekë për vërtetimin (në total 700 lekë);
- o Noterizime të ndryshme për aktet; në disa raste kur janë me KMCAJ u kërkohet të noterizojnë Vendimin e KMCAJ-it (afërsisht 3,000 lekë);

Pra kosto mesatare totale me qëllim mbledhjen e vërtetimeve shkon në vlerën e 700 lekëve për një individ, pa llogaritur në disa raste dhe noterizimin e akteve/dokumenteve të nevojshme sipas rastit specifik të individit. Duke marrë parasysh që përfituesit e ndihmës juridike janë kategoritë më vulnerabël, kostot janë relativisht të larta, e çënojnë aksesin dhe të drejtën e përfitimit të shërbimit ligjor falas.

• Fuqizimi dhe riintegrimi

Shërbimet që ofrohen për kategoritë përfituese janë thelbësore për të siguruar një mbështetje ndërsektoriale e për të mundësuar riintegrimin social të individëve e familjeve në nevojë.

28 Burimi: Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, 2021.

Mungesa me shërbime të specializuara për PAK mbetet sfidë. Në bashki të vogla, si Bashkia Mat ka vetëm një qendër jo publike ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara deri në moshën 18 vjeç. Mungesa e kurseve të përshtatshme të formimit profesional dhe oferta e punësimit për kategoritë në fokus është edhe më e mprehtë në bashkitë e vogla. “Shkalla e papunësisë është e lartë, mungojnë kurset e kualifikimeve të përshtatshme e s’ka as mundësi për të zhvilluar iniciativa sipërmarrjeje për aplikantët e NE” – Bashkia Mat.

Ndihma ekonomike dhe riintegrimi social - histori njerëzore

Rasti i Anisë:* Anisa, 38 vjeç, banuese në një bashki të madhe, nënë e një vajze dy vjeç e gjysmë, ka kontaktuar për herë të parë gjatë kohës së karantinës Linjën e Këshillimit. E shqetësuar nga situata e dhunës së ushtruar, gjen mundësinë të telefonojë në Linjën e Këshillimit. Gjatë bisedës shprehet se karantina përkeqësoi dhunën dhe kish marrë një UMM në vijim të denoncimit e, më pas, UM me një afat dy mujor.

Anisa jetonte me frikë pasi afati i UM ishte shumë i shkurtër e u mbështet nga Linja me përfaqësim në gjykatë për përcaktimin e kujdestarisë së vajzës dhe detyrimin ushqimor. Në vijim u mbështet dhe me aplikimin për bonus qiraje, të cilin e përfitoi vetëm pas shtatë muajsh. Gjatë kësaj periudhe interesohej rregullisht në bashki dhe nuk merrte përgjigje për vonesën, ndërkohë që gjendja e saj ekonomike vështirësohej dhe kishte qira të prapambetura.

Më pas, edhe pse e përfitoi pas shtatë muajsh bonusin e qirasë, hasi vështirësi me qiradhënesin, i cili nuk ia rinovoi më kontratën për shkak të pagesave të prapambetura. Në mungesë të kontratës, bonusi i qirasë iu ndërpre. Anisa, nënë e vetme, e papunë, pa të ardhura, aplikoi dhe për ndihmë ekonomike dhe nuk e përfitoi menjëherë deri sa arriti të rinovojë UM.

Sfida tjetër lidhet me regjistrimin në kopsht të vajzës. Drejtoresha e kopshtit refuzonte ta regjistronte në mungesë të vendeve, e vetëm pasi u ankua arriti ta regjistronte fëmijën. Drejtoresha nuk e informoi Anisën se ishte e përjashtuar nga pagesa e tarifës për kopshtin e vajzës si përfituese e NE, me justifikimin se “nuk është detyra ime të informoj”. Pas informimit nga këshillueset, Anisa, u ballafaqua me drejtoreshën e kopshtit dhe aktualisht vajza frekuenton kopshtin falas. Ajo vazhdon të ndiqet nga stafi i Linjës dhe për procesin e ekzekutimit të detyrimit ushqimor dhe futjen në punësim.

Burimi: Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Aksesueshmëria është gjithashtu një sfidë e patrajtuar plotësisht për të lehtësuar aksesin e PAK në shërbime.

Për viktimat e dhunës në familje, strehimi, punësimi e aksesin në institucionet arsimore për fëmijët e tyre mbeten nevojat prioritare. Në mungesë të shërbimeve, bashkitë janë përpjekur të punojnë më ngushtë me familjet e origjinës për të siguruar mbështetje për viktimat e dhunës. Mungesa e strehëzave dhe kapacitetet e limituara të atyre ekzistuese janë një pikë e dobët e sistemit. Përfitimi nga programet e strehimit shoqërohet nga një numër sfidash çka ka rezultuar në vonesa. “Strehimi është një kalvar procedural” – shprehen punonjësit e njërës prej bashkive.

Për marrjen e bonusit të qirasë edhe pse janë priorizuar gratë e dhunuara, programi është i ngurtë pasi aplikimi ndodh rreth dy herë në vit e bashkitë nuk kanë fleksibilitet në buxhetet e tyre për të mbuluar nevojat imediate të strehimit. Probleme të tjera lidhur me **bonusin e qirasë**, vijnë si pasojë e vonesës së pagesës nga bashkia (rasti i Bashkisë Tiranë) duke bërë që qiradhënësit të refuzojnë të vazhdojnë marrëveshjen apo të marrin raste të tjera. Në rastet kur bashkia vendos të hyjë në marrëdhënie direkte me qiradhënësin e të kryejë vetë pagesën, hasen vështirësi në gjetjen e shtëpisë me çmimin e duhur. Detyrimi për të paguar taksën (15%) bashkë me vonesën e pagesave nga bashkitë janë faktorë dekurajues për qiradhënësin për të materializuar një marrëdhënie kontraktuale qiraje me bashkitë.

Refuzimi i ofertave të punës i përjashton familjet në nevojë nga skema e ndihmës ekonomike. Në rastin e grave të dhunuara, “përjashtimi nga skema e NE pas refuzimit të tri ofertave të punës, bëhet duke harruar që ajo grua, që mund të mos ketë punuar më parë ose ka qene e izoluar për një kohë të gjatë, ka vetëbesim të ulët”. Situata e grave të dhunuara përfituese të NE është shumë më komplekse e kërkon një qasje ndërsektoriale për të adresuar nevojat e tyre për riintegrim social, përndryshe ato rrezikojnë të humbasin përmes hallkave të sistemit. Në pjesën më të madhe të rasteve, gratë e dhunuara nuk arrijnë të marrin mbështetjen e plotë me shërbime. Një pjesë gjejnë mbështetje të familjet e tyre, por ato pa asnjë mbështetje nuk arrijnë të qëndrojnë në punë sepse nuk mund të sigurojnë kujdesin për fëmijët. Në mungesë të mbështetjes në disa drejtime, si kujdesi për fëmijët, problemi i strehimit, e vështirësi të tjera që ndikojnë negativisht për të patur një jetesë të pavarur, viktimat e dhunës rikthehen pranë bashkëshortëve e ripërsëritet cikli i dhunës.

Ndihma ekonomike dhe riintegrimi social - histori njerëzore

Rasti i Lorit:* Lori 40 vjeç me 3 fëmijë, është përfituese pranë Linjës së Këshillimit prej më shumë se një viti. Ajo është paraqitur fillimisht si një rast viktime dhune në familje e më pas ish-bashkëshorti u dënua me burg si dhunues. Në kohën që Lori kontakton me Linjën, ish-bashkëshorti ishte në përfundim të dënimit dhe për dy ditë do të dilte nga burgu. Ishte shumë e frikësuar, pasi ai e kërcënonte që nga qelia se, sapo të dilte, do ta vriste atë dhe njerëzit e saj të afërm.

Lori ka përjetuar një dhune ekstreme me rrezikshmëri shumë të lartë për jetën e saj. Nisur nga vlerësimi i detajuar i këshilluesve të Linjës, pa patur një dhunë konkrete në momentin që gruaja u paraqit pranë Linjës, u bë e mundur të sigurohej një UMM, urdhër i cili më pas u vërtetua dhe u lëshua për një vit. Lori aplikoi në programet e strehimit e përfitoi bonus qiraje.

Më tej, kontaktoi sërish me Linjën me shqetësimin se kishte dy muaj që nuk po merrte dot bonusin e qirasë. Kjo situatë i kishte sjellë probleme me qiradhënësin, i cili e kishte paralajmëruar se do t'i prishte kontratën dhe do ta nxirrte nga shtëpia.

Për Lorin ky ishte burimi i vetëm i të ardhurave për qiranë. Mospërfitimi dhe vonesat e rëndonin tej mase gjendjen në nivel mbijetese për të dhe familjen së saj. Lori kërkon mbështetje për ndihmë ekonomike nga Linja. Nga ana e bashkisë nuk i është bërë e qartë arsyeja e vonesës së bonusit të qirasë. Sipas informacionit të mundësuar përmes koordinimit të stafit të Linjës me bashkinë, u informua se fondet kishin patur një vonesë, që ka rezultuar në një praktikë të përsëritur.

Burimi: Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza

Roli i organizatave të shoqërisë civile është shumë i rëndësishëm për informimin e kategorive të veçanta dhe ofrimin e shërbimeve. Megjithatë organizatat u shprehën se ka nevojë që dhe nga ana e tyre të përmirësohet ofrimi i informacionit, përtej shërbimit që ofrohet përmes organizatës specifike, duke patur parasysh shportën e shërbimeve ekzistuese për të informuar viktimat e dhunës në familje dhe PAK.

3.3. Fryma e legjislacionit lidhur me pagesat paralele për kategoritë në fokus

Neni 12 i Ligjit për Asistencën Sociale shprehet për **pagesën e ndihmës ekonomike** dhe parashikon se familjet dhe individët në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë dhe mënyra për përfitimin përcaktohet me VKM. Pra, krahas pagesës së ndihmës ekonomike, familjet në nevojë marrin paralelisht edhe pagesa të tjera²⁹ dhe përfitime në natyrë.

Ndërkohë që parashikon këto përfitime dhe pagesa paralele për pjesëtarët e familjes në nevojë, neni 12 pika 6 i Ligjit (57/2019) parashikon shprehimisht: *“Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve të nenit 7 të këtij ligji, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen”*. Nga pikëpamja strikte ligjore, viktimat e dhunës në familje (VDF) përfshihen në kategorinë e përfituesve të ndihmës ekonomike sipas nenit 7, gërma ‘d’, të ligjit. Si rrjedhojë, në bazë të pikës 6 të nenit 12 të sipërcituar, nëse një individ përfiton ndihmë ekonomike si viktimë e dhunës në familje nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës për familjen. Ky qëndrim i ligjit konfirmohet shprehimisht edhe në VKM përkatëse³⁰ e miratuar në zbatim të Ligjit për Asistencën Sociale në Kreu III, pika 12, ku parashikohet: *“Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo individ, përfitues i ndihmës ekonomike përkatëse, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen”*.

VKM Nr. 597 datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, i cili është miratuar në bazë të nenit 12, pika 1, 4 e 5, nenit 16 pika 2, e nenit 21 të Ligjit për Asistencën Sociale, parashikon në pikën 8 të kreut të tretë të saj

29 Neni 12 i Ligjit për Asistencën Sociale parashikon se fëmijët e familjeve në nevojë marrin pagesë shtesë për ndjekjen e arsimit dhe fëmijët e familjeve në nevojë dhe jetimët që nuk janë në institucione marrin një pagesë shtesë për çdo vaksinë të kryer.

30 VKM Nr. 597 datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar.

se “Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohet në institucionet e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është 3,000 (tre mijë) lekë në muaj. Kjo ndihmë ekonomike përfitohet gjatë periudhës së vlefshmërisë të urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të përcaktuar në vendimin e gjykatës”.

Për viktimën e dhunës në familje përfitimi nga ndihma ekonomike bazohet jo vetëm në Ligjin për Asistencën Sociale dhe në VKM 597 të miratuar në bazë të këtij ligji por, edhe në Ligjin për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare. Neni 6, pika ‘c’³¹ e këtij ligji parashikon se autoriteti kryesor përgjegjës ka për detyrë, krahas të tjerave, edhe mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, si dhe plotësimin e të gjithë infrastrukturës së nevojshme që shërben për mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në famije, përfshirë asistencë financiare dhe shërbime mjekësore e sociale sipas legjislacionit në fuqi.

Për efekte të masës së pagesës së ndihmës ekonomike vlen të përmendet se VKM 597/2019 parashikon se Ministri përgjegjës për çështjet sociale nxjerr udhëzim për mënyrën e përllogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, sipas strukturës së familjes³². Ky akt parashikon shprehimisht se kur në përbërjen e strukturës së familjes, për efekt të llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike, mbetet vetëm një anëtar, masa e ndihmës ekonomike për këtë të fundit është ajo e llogaritur për këtë anëtar dhe se për bashkëshortët në proces zgjidhje martesë, kur ende nuk ka një vendim gjykate të formës së prerë, masa e ndihmës ekonomike për secilin bashkëshort do të jetë e përllogaritur në bazë të strukturës së familjes.

Bazuar në kreun I, pika 1, të VKM Nr.182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personale”, i ndryshuar, i cili është miratuar në bazë të nenit 13 e 17, pika 1, të Ligjit për Asistencën Sociale, përfitojnë pagesë të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar në pikat ‘a’ dhe ‘b’ të nenit 8 të Ligjit për Asistencën Sociale, pra,

31 Neni 6, pika ‘c’ e Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.

32 Udhëzimi nr. 3 datë 17.02.2017 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.955, datë 07.12.2016 të për përcaktimin e kriterëve të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”.

personat paraplegjike dhe tetraplegjike dhe personat me aftësi të kufizuar që deklarohen të paafhtë për punë. Pika 1 e Kreut III të VKM 182/2020 parashikon masën e pagesës për aftësi të kufizuar.

Pika 10 e Kreut III të VKM 182/2020 parashikon shprehimisht se përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike. Siç kuptohet, ky parashikim nuk çënon pagesën paralele të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të pagesës së ndihmës ekonomike të familjes në nevojë; kjo dispozitë lehtëson marrjen e ndihmës ekonomike si individ apo pjesëtar i familjes në nevojë kur ky i fundit është përfitues i pagesës së aftësisë së kufizuar. Kjo pikë 10, duhet kuptuar që të ardhurat nga pagesa e aftësisë së kufizuar nuk llogariten në të ardhurat e familjes që kërkon të përfitojë ndihmë ekonomike si familje në nevojë.

Më tej, për qëllime të kësaj analize duhet të mbajmë parasysh se në Kreun III, pika 13/dh, e VKM nr. 182/2020 parashikohet se përfitimi i pagesës për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar nga personat me aftësi të kufizuar ndërpritet për personat e përcaktuar në nenin 11³³ të Ligjit për Asistencën Sociale, pra, të personave që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit.

Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” parashikon shërbime e lehtësi për individët dhe familjet në nevojë krahas skemës së ndihmës ekonomike. Më tej, pa kundërshtuar parashikimet përkatëse të Ligjit për Asistencën Sociale, në VKM 182/2020 nuk kemi përjashtim të shprehur që nëse përfitohet pagesa për aftësi të kufizuar, nuk paguhet masa e ndihmës ekonomike si familje në nevojë.

Siç është përshkruar më sipër, pagesat kryesore të parashikuara në Ligjin për Asistencën Sociale³⁴ dhe ligje të tjera të veçanta në fuqi përkatëse për kategoritë në fokus, si Ligji për Masa ndaj Dhunës në Familje³⁵, për të cilat ka patur aplikime/kërkesa, janë si vijon: **pagesat si viktime të dhunës në familje**,

33 Neni 11 i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” parashikon se nuk përfitojnë nga ligji: “...dh) personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar”.

34 Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”

35 Ligji nr. 966, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në familje”, i ndryshuar

ndihmë ekonomike si individ/pjesëtar i familjeve në nevojë, pagesa për PAK (këto pagesa kryesore nuk përfshijnë pagesat që merren për shkak të statusit të veçantë të parashikuar me ligj të veçantë përkatës³⁶). Më tej, legjislacioni parashikon edhe pagesa të tjera, si pagesa për vaksina, shkollim, etj. (përfshirë bonus i bebes, etj), dhe përfitime të tjera në natyrë, ku përfshihen ndihmësi personal, mbështetja me mallra ushqimore dhe të përdorimit të përditshëm, mjete lëvizëse, në veshmbathje, kompensim për energjinë elektrike / kompensim cmimi energjie, etj.

Në lidhje me pagesat e ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera të sipërshkruara, janë identifikuar si më poshtë:

- **Kufizimi i pagesave paralele**

Tendenca e legjislacionit në përgjithësi është që të kufizojë pagesat paralele në sistemin e asistencës sociale (shih më poshtë në këtë seksion dhe në seksionin 3.3.1 të këtij Raporti dhe Shtojcën 2 të këtij Raporti). Kështu, nga pikëpamja strikte ligjore, i njëjti individ nuk mund të marrë njëkohësisht pagesë NE si VDF dhe pagesë NE si individ apo pjesëtar i familjes në nevojë (neni 7 & neni 12, pika 6, e Ligjit për Asistencën Sociale). Në praktikë, marrja e pagesës NE si VDF nuk mundëson pagesën NE si individ apo pjesëtar i familjes në nevojë.

Neni 6 i Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Familje parashikon se autoriteti kryesor përgjegjës ka për detyrë mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, **përfshirë këtu asistencë financiare**, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi. Bazuar në sa më sipër, dispozitat e Ligjit për Masa ndaj Dhunës në Familje (neni 6 pika ‘c’) i referohen Ligjit për Asistencën Sociale; ky i fundit i kategorizon viktimat e dhunës në familje si përfitues të ndihmës ekonomike (neni 7), ndërsa neni 12 parashikon për ndalim të përfitimit të dyfishtë nga pagesat e NE dhe, si rrjedhin, arrijmë në konkluzionin se kemi ndalim të pagesave paralele brenda skemes së pagesave të NE.

36 Ligji 8098/1996, Ligji 8626/2000, Ligj 7889/1994.

Pavarësisht që VDF mbrohen nga një ligj i veçantë sipas të cilit viktimë e dhunës në marrëdhëniet familjare janë personat mbi të cilin është ushtruar çdo veprim ose mosveprim nga një person, që sjell si pasojë cënimin të integritetit fizik, moral, psikologjik, seksual, social-ekonomik, dhe për të cilin është lëshuar urdhër mbrojtjeje ose urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje me vendim gjykatë, sipas Ligjit për Asistencën Sociale, viktimat e dhunës në familje do të përfitojnë masën e NE vetëm si një kategori e NE (ose si VDF ose si individ/pjesëtar i familjes në nevojë). Kujtojmë që në praktikë, përfituesit e pagesës së NE si VDF përjashtohen nga përfitimi, nëse bën pjesë, si kategori individ apo pjesëtar i familjes në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme. Ky qëndrim praktik duket që bazohet në interpretimin e zgjeruar (pra, zbatimit në çdo rast kur ka statuse të njëkohëshme për të njëjtin individ, pavarësisht nga statutet paralele) të pikës 6 neni 12 të Ligjit për Asistencën Sociale.

Neni 12, pika 6, e Ligjit për Asistencën Sociale përjashton pagesat paralele edhe në rastin e pagesës për aftësi të kufizuar, të anëtarit të familjes në nevojë që është PAK, invalidët e punës, apo individët përfitues të ndihmës ekonomike sipas përcaktimeve të nenit 7 (përfshirë VDF) të Ligjit për Asistencën Sociale. Sipas kësaj dispozite, këtyre personave nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike që përfitojnë individët apo pjesëtarët/familjet në nevojë. Në lidhje me këtë, sic është shkruar më sipër, kujtojmë që pika 10 e Kreut III të VKM 182/2020 parashikon shprehimisht se përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike duke kuptuar që, pa kundërshtuar nenin 12, pika 6, të Ligjit për Asistencën Sociale, ky parashikim i kësaj VKM nuk çënon në mënyrë të shprehur pagesën në mënyrë paralele të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të pagesës së ndihmës ekonomike të individit apo familjes në nevojë. Qartësimi ligjor me dispozita të shprehura në lidhje me pagesat PAK dhe pagesat e NE në nevojë është e domosdoshme.

Pa kundërshtuar më sipër, në vështrim të përgjithshëm, nuk ka kushte të parashikuara shprehimisht në ligj për zbatim/lejime të pagesave paralele kur gjendja ekonomike e individit / pjesëtarit të familjes në nevojë nuk është e përshtatshme dhe dinjitoze. Po ashtu, nuk ka dispozita ligjore që të lidhin ndalimin e pagesave paralele me nivelin e të ardhurave të paktën sa minimumi jetik i përllogaritur (pavarësisht se nuk është miratuar minimumi jetik në shkallë

vendi) apo me ndonjë referencë tjetër të ngjashme (si p.sh., paga minimale, etj.) apo me standardin kushtetues të jetës dinjitoze.

Gjithashtu, në rastin e ndalimeve të pagesave paralele nuk ka qartësi se cila pagesë mbizotëron, pra, nëse përfitimi nga pagesat NE si VDF apo pagesat përkatëse për NE si individ/pjesëtar i familjes në nevojë, etj.; nuk ka udhëzim të shprehur nëse individ ka të drejtën e zgjedhjes të pagesës më të lartë në shumë absolute, etj.

- **Zbatimi i pagesave paralele**

Pa kundërshtuar sa më sipër, në dispozita të veçanta të ligjeve të ndryshme përkatëse ka lejim të pagesave të asistencës sociale dhe të përfitimeve paralele. Në qoftë se, një individ do të ishte në kategorinë e përfituesve të ndihmës ekonomike si individ / pjesëtar i familjes në nevojë, përveç masës së pagesës së ndihmës ekonomike si individ/pjesëtar i familjes në nevojë do të përfitonte edhe pagesë për shkak të statusit të veçantë (pra, parashikuar jo nga Ligji për Asistencën Sociale por, nga ligjet e veçanta të mëposhtme mbi statutet përkatëse) që i jep ligji disa kategorive të personave PAK (shih më poshtë).

Ligji nr.8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, në nenin 5, parashikon se “...pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitojnë nga shteti, të verbërit marrin një pagesë shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie. Po këtë masë e përfiton edhe kujdestari i tyre të cilin e zgjedhin vetë”.

Neni 15 i Ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar, parashikon se invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik.

Ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve”, i ndryshuar, parashikon se statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale, që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore, sipas Ligjit nr. 4171, datë 13.09.1996 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pra, personat invalidë të punës nëse janë individ/pjesëtar të familjes në nevojë, përveç pensionit të invaliditetit nga

sistemi i sigurimeve shoqërore mund të përfitojnë për shkak të statusit të tyre në nevojë edhe ndihmë ekonomike si individ/familje në nevojë, por duhet të heqin dorë nga PAK bazuar në Ligjin për Asistencën Sociale.

Neni 18 i Ligjit për Asistencën Sociale parashikon se personat që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe pagesës së aftësisë të kufizuar përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktiv, në kuptim të skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

Neni 10 i Ligjit për Asistencën Sociale parashikon se përfitojnë një ndihmës personal personat paraplegjik dhe tetraplegjik, personat me aftësi të kufizuar të paaftë për punë dhe personat me aftësi të kufizuar të deklaruar me Vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë së Kufizuar.

Neni 12, pika 4 dhe 5, të Ligjit për Asistencën Sociale, parashikon se fëmijët e familjes në nevojë, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe jetimët, që nuk janë në institucione që ndjekin arsimin e detyrueshëm marrin një pagesë shtesë deri në përfundimin e arsimit të detyrueshëm, si dhe një pagesë shtesë për çdo vaksinë të kryer.

Kur ka zbatim të pagesave paralele si p.sh. pagesë NE si viktimë e dhunës në familje dhe pagesë për të verbrit të cilët janë viktima të dhunës në familje, nuk merret në vlerësim gjendja ekonomike e individit/pjesëtarit të familjes përkatëse. Parimi është që këto pagesa merren në mënyrë paralele në kushtet që i njëjti person kategorizohet ligjërisht edhe si i verbër edhe si viktimë e dhunës në familje. Ky parim zbatohet edhe për invalidët dhe personat paraplegjike dhe tetraplegjike të cilët janë VDF; ata fitojnë edhe pagesën si invalidë apo paraplegjike apo tetraplegjike edhe pagesën NE si viktimë e dhunës në familje.

Pa kundërshtuar sa më sipër, në vështrim të përgjithshëm, nuk ka kushte të parashikuara në ligj për zbatime të pagesave paralele të sipërpërkrahura në varësi të gjendjes ekonomike të individit/pjesëtarit të familjes në nevojë përkatëse dhe nuk ka dispozita ligjore të cilat e lidhin zbatimin e pagesave paralele nëse plotësohet të paktën minimumi jetik i përlllogaritur (pavarësisht se nuk është miratuar minimumi jetik në shkallë vendi) apo me ndonjë referencë tjetër e ngjashme apo me standardin kushtetues të jetës dinjitoze.

- **Qëndrim diskrecional mbi pagesat paralele**

Në disa dispozita ligjore, në lidhje me disa pagesa të skemës së asistencës sociale dhe pagesave të tjera që bazohen në ligje të tjera (Ligji për Sigurimet Shoqërore dhe ligjet mbi statutet e grupeve të veçanta), nuk ka qëndrim të shprehur në lidhje me zbatimin e pagesave paralele. Në këto raste, tendenca e interpretimit ligjor në praktikë është ndalimi i pagesave paralele.

Në lidhje me përfitimet paralele, nuk ka qartësi në legjislation nëse ndalohen ose lejohen përfitimet e tjera (të ndryshme nga pagesat), p.sh. nëse kur përfitohet në natyrë, a ndalohet NE apo anasjelltas, etj.

Diskrecion në lidhje me aplikimet për pagesat paralele shohim në rolin e administratorit shoqëror i cili ka detyrë plotësimin e aplikimeve të personave të kualifikueshëm dhe të dhënave përkatëse në sistemelelektronik / Regjistrin Kombëtar Elektronik të kategorive të përfituesve. Saktësia në kryerjen e aplikimeve dhe plotësimin e të dhënave përkatëse, në raste të veçanta, çon në lejim ose pengim të pagesave paralele nga skema e ndihmës ekonomike, dhe në disa raste kufizim të përfitimit të pagesave të kategorive të caktuara.

Ligji për Asistencën Sociale lejon marrjen e plotë të ndihmës ekonomike që përfitojnë individët ose pjesëtarët e familjes në nevojë dhe kjo masë nuk kufizohet nga numri i anëtarëve. Në pikën 2 të nenit 12 të Ligjit për Asistencën Sociale parashikohet se pagesë të ndihmës ekonomike përfitojnë familjet që ***nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore***³⁷, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera ***dhe*** individët e përcaktuar në nenin 7, pra, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike. Nga pikëpamja strikte ligjore, kuptojmë që individët dhe pjesëtarët e familjes në nevojë që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore përfitojnë ndihmë ekonomike kur janë pjesë e kategorive të parashikuara nga neni 7 (pra, NE) i Ligjit për Asistencën Sociale.

Gjithashtu, mbetet diskriminues neni 12, pika 6, e Ligjit për Asistencën Sociale në lidhje me pagesat dhe përfitimet që kanë personat përkatës subjekte të tjera veçmas atyre që përfitojnë nga Ligji për Statusin e Invalidit, Ligji për Statusin e të Verbrit dhe Ligjit për Invalidët Paraplegjik dhe Tetraplegjik:

37 Sipas Ligjit për Sigurimet Shoqërore.

nëse një individ nuk kualifikohet si invalid, i verbër apo paraplegjik dhe tetraplegjik, por është PAK dhe është individ/pjesëtar i familjes në nevojë, ai/ ajo nuk përfiton edhe pagesë NE si person në nevojë edhe pagesë për shkak të statusit si PAK.

Disa prej bashkive kanë standarde të ndryshme në lidhje me ofrimin e ndihmës ekonomike për viktimën e dhunës në familje për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose të urdhrin të mbrojtjes të formës së prerë³⁸. Pa kundërshtuar parashikimet ligjore të shprehura të legjislacioni e çfarë është shkruar më sipër në lidhje me urdhrat e mbrojtjes për qëllime të përfitimit të NE, në disa raste, UMM nuk konsiderohet si vendim i ekzekutueshëm për të legjitimuar përfitimin e masës së ndihmës ekonomike për VDF. Në këto raste, UMM konsiderohet si një hap procedural paraparak deri në marrjen e urdhrin të mbrojtjes së formës së prerë. Kjo edhe sepse UMM nuk përmban numër vendimi por vetëm datë dhe në sistemin elektronik/Regjistrin Elektronik Kombëtar të ndihmës ekonomike nuk mund të popullohet me këtë mangësi. Megjithatë, në këto raste, praktika duhet të mbajë në vëmendje që VKM 597/2019 parashikon që viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes të formës së prerë ose të UMM kanë për detyrë të paraqesin kopjen e kartës së identitetit dhe urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes. Pra, kjo dispozitë orienton që, nga pikëpamja strikte ligjore, pagesa e NE si viktimë e dhunës në familje legjitimohet si nga urdhri i mbrojtjes i formës së prerë ashtu edhe nga urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes (pika 4.5 e VKM 597/4.09.2019).

Gjithashtu, në Ligjin për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare parashikohet se vendimi i gjykatës për nxjerrjen e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes përbën titull ekzekutiv dhe nuk mund të ankimohet. Vendimi ekzekutohet menjëherë nga organet e policisë, në bashkëpunim me shërbimin përmbartimor gjyqësor dhe zyrën e shërbimeve sociale të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku janë me banim të përhershëm ose të përkohshëm viktimat dhe personat e tjerë të parashikuar në vendim.

38 Në Ligjin për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare parashikohet se “Urdhër mbrojtjeje” është urdhri me vendim gjyqësor, ku parashikohen masat mbrojtëse për viktimën, fëmijët, dhe sipas rastit, masa për rehabilitimin e dhunuesit; “Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje” është urdhri i lëshuar përkohësisht më vendim gjyqësor, i vlefshëm deri në lëshimin e Urdhrin të Mbrojtjes me vendim gjyqësor.

Për çështjet diskrecionale të paraqitura në këtë pikë të këtij Raporti, nuk ka qëndrim të unifikuar (strukturat bashkiake apo rajonale nuk mbajnë të njëjtin qëndrim ndalues apo lejues).

Në nenin 29³⁹ të Ligjit për Asistencën Sociale parashikohet e drejta e aplikuesit për ankim administrativ dhe gjyqësor. Parashikimi i mekanizmit ligjor të ankimit mundëson mbrojtjen efektive të të drejtave të aplikuesve kur mohohet e drejta për pagesa e përfitime të veçanta nga skema e ndihmës ekonomike, kur mohohet e drejta për pagesa paralele në rastet kur ligji është i qartë për mosndalimin e tyre, si edhe kur ligji mundëson diskrecion të administratorit shoqëror, etj. Në praktikë, konstatuam që nuk përdoret mekanizmi i ankimit apo mundësitë e mjetet e tjera përkatëse ligjore që parashikon legjislacioni për kundërshtimin e mosdhënies së pagesave paralele.

3.4. Përshtatshmëria e masës së NE

3.4.1. Masa e NE e krahasuar me nivelin e varfërisë

Masa e ndihmës ekonomike është shumë e vogël e kërkon rishikim për të përballuar kostot e jetesës. Administratorët shoqërorë theksuan dhe nevojën për rishikimin e formularit të aplikimit për NE, duke përshtatur elementet e vlerësimit të situatës socio-ekonomike me kontekstin aktual.

39 Neni 29 i Ligjit për Asistencën Sociale: "1. Aplikuesit për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuara, kur gjykon se i është shkëtur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrtton ankesën dhe njofton me shkrim ankesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuara, që pretendojnë se u është shkëtur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Përfituesit kanë ngritur vazhdimisht shqetësimin, pranë punonjësve të bashkive dhe organizatave të shoqërisë civile, se masa e ndihmës ekonomike nuk është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat bazike të ushqimeve dhe pagesën e faturave mujore. Sipas përfaqësuesve të institucioneve publike dhe shoqërisë civile në kontakt të vazhdueshëm me kategoritë në nevojë, një pjesë e përfituesve e përdorin ndihmën ekonomike për nevojat ushqimore të javës pasi nuk del për gjithë muajin. Të tjerë, në mungesë të informacionit e përdorin për të mbuluar ndonjë pagesë kopshti apo çerdheje – edhe pse këto shërbime duhet të ofrohen falas nga bashkitë përfituesit e NE.

Ndihma ekonomike përllogaritet në bazë të një formule të pikëzuar duke marrë parasysh parametra të tillë si: kushtet e jetesës, të ardhurat nga emigracioni, demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin, të ardhurat nga programet e mbrojtjes sociale - një prej të cilave është edhe pagesa e përfituar nga viktimat e dhunës në familje. Ndërsa masa mesatare e NE për një familje në nevojë është 5,161 lekë në muaj, kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një familje me 1 anëtar është llogaritur në 170,785 lekë në vit, ose 14,232 Lekë në muaj, nga INSTAT, me metodologjinë Eurostat- për matjen e nivelit të jetesës dhe varfërisë relative (INSTAT, AANJ 2019). Për të krijuar një perspektivë tjetër, INSTAT kalkulon se kufiri i rrezikut për të qenë i varfër për një familje me 2 të rritur dhe 2 fëmijë në varësi, në terma monetarë është 358,650 lekë në vit, ose 29,887 lekë në muaj. Si në nivel individual - qoftë kur i referohemi NE apo masës së pagesës si viktimë e dhunës - ashtu dhe familjar, masat e NE janë mjaft të ulta përkundër kufirit të varfërisë. Në rastin e një familjeje me 4 anëtarë, masa e NE është 5.7 herë më e ulët se kufiri i varfërisë.

Ndërsa rreziku për të qenë i varfër raportohet të jetë 23% e popullsisë në vitin 2019 sipas INSTAT mungesa e aksesit tek përfitimet sociale do e çonte këtë tregues në nivelin 38.1% për të njëjtin vit, një dinamikë që konfirmon se aksesit tek përfitimet sociale dhe masa e këtyre përfitimeve janë shumë të rëndësishëm për pjesën vulnerabel të popullsisë.

Tabla 4: Treguesit e rrezikut për të qenë i varfër dhe përjashtimit social

Treguesit	2017	2018	2019
Rreziku për të qenë i varfër %	23.7	23.4	23
Rreziku për të qenë i varfër para përfitimeve sociale %	40.4	39	38.1
Rreziku për të qenë i varfër ose përjashtimi social (AROPE) %	51.8	49	46.2

Burimi: Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2017, 2018, 2019 INSTAT

Ndërkaq, numri i individëve në rrezik për të qenë të varfër ose në përjashtim social⁴⁰, edhe pse ka pësuar ulje, në nivelin 46,2% të popullsisë mbetet mjaft i lartë.

Gjetjet e Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës (AANJ, 2019) sugjerojnë se personat me përfitime të aftësisë së kufizuar përballen me një rrezik më të lartë të varfërisë dhe përjashtimit social (AROPE) në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Në vitin 2019, norma AROPE për popullsinë totale të moshës 16+ ishte 45.6% me një rënie me 2.7 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018. Norma AROPE për personat pa aftësi të kufizuara në vitin 2019 ishte 42.1% duke u ulur me 1.2 pikë përqindje krahasuar me 2018. Për në të njëjtën periudhë, për personat me aftësi të kufizuara shkalla AROPE ishte 47.7% duke u ulur me 5.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2018. Për personat me aftësi të kufizuara mesatare norma AROPE ishte 44% në 2019 duke u ulur me 3 pikë përqindje nga viti 2018. Në rastet e paaftësisë së rëndë, norma AROPE është edhe më e lartë duke arritur në 63.8% në 2019 duke u ulur me 4 pikë përqindje krahasuar me 2018.

40 Në rrezik varfërie ose përjashtimi social, shkurtuar si AROPE, korrespondon me shumën e personave që janë ose në rrezik varfërie, ose të privuar rëndë nga pikëpamja materiale dhe sociale, ose që jetojnë në një familje me një intensitet shumë të ulët pune. Në llogaritjen e këtij treguesi njerëzit përfshihen vetëm një herë, edhe nëse janë në më shumë se një nga situatat e përmendura më sipër. Treguesi AROPE është pjesa e popullsisë së përgjithshme që është në rrezik të varfërisë ose përjashtimit social. Ai është treguesi kryesor për monitorimin e objektivit të BE-së 2030 për varfërinë dhe përjashtimin social.

3.4.2. Masa e NE dhe minimumi jetik

Deri më sot nuk është gjykuar e përshtatshme të përcaktohet minimumi jetik në Shqipëri; presionet e mundshme ndaj financave publike mund të kenë frenuar miratimin e minimumit jetik. Ndaj edhe përcaktimet e masës së NE, pagesave në rastet e dhunës në familje etj., mbeten të palidhura me njëra tjetrën, dhe të llogaritura me metoda të ndryshme, ose dhe arbitrare, edhe pse të gjitha synojnë mbrojtjen sociale të kategorive në nevojë. Në fakt, vlerësohet se masa e NE përmbush vetëm 25% të nevojave të konsumit që ka një familje (UNICEF, 2019). Minimumi jetik në Shqipëri për vitin 2019, i llogaritur përmes një studimi nga institucioni i Avokatit të Popullit, vlerësohet të jetë përafërsisht 17, 875 lekë për një rritur që harxhon 2,288 kalori në ditë. Kjo vlerë e llogaritur përmes metodës së varfërisë absolute është 9.9 % më e lartë sesa pensioni minimal për zonat urbane, 37.5 % më e lartë se pagesa e papunësisë dhe rreth 3 herë më e lartë se ndihma ekonomike për një familje me 1 person.

Sipas studimit për transfertat e mbrojtjes sociale (UNICEF, 2019), ku janë listuar kategoritë e shpenzimeve për familjet e varfëra, ushqimi zë pjesën më të madhe të shpenzimeve (rreth 96%) duke kufizuar fort hapësirat për shpenzime që lidhen me aktivitete të zhvillimit njerëzor si shëndeti apo edukimi, apo edhe aktivitete të tjera zhvilluese si transporti, komunikimi, çlodhja dhe kultura.

Një tjetër tregues që tregon pamjaftueshmërinë e masës së pagesave të NE, mesatarisht 5,161 lekë në 2020 - përfshi edhe për viktimat e dhunës në familje, është dhe vlerësimi për shpenzimet mesatare mujore për një familje me 3.7 anëtarë në rendin e 82,235 lekë (INSTAT, ABF 2019). Vetëm shpenzimet për ushqime dhe pije jo-alkolike llogariten të jenë 33,952 lekë.

Kjo do të thotë, që jo vetëm masa e NE është shumë e ulët, por edhe që ndihmon në krijimin e ciklit të mbyllur të varfërisë duke i mbajtur grupet e cënueshme në të njëjtat kushte, pa u krijuar mundësi për t'u arsimuar apo zhvilluar që të mund të dalin nga ky cikël. Ende nuk ka të dhëna apo studime që vlerësojnë se në çfarë niveli kjo masë ndihmon për zbutjen e varfërisë në nivel kombëtar apo rajonal; sa familje kanë dalë nga skema e NE-së në nivel kombëtar apo rajonal si pasojë e zbatimit të strategjive për daljen nga skema dhe ri-integrimin socio-ekonomik të tyre. Masa e NE, dhe në përgjithësi i gjithë sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri do mund të harmonizohej dhe të kishte koherencë nëse do

bazohej mbi një minimum jetik të përcaktuar në legjislacion.

Masa e përfitimit mujor për viktimat e dhunës në familje është 3,000 lekë e përcaktuar në mënyrë arbitrare në legjislacion pavarësisht nga përbërja e familjes. Kjo pagesë është e palidhur apo referuar me ndonjë pagesë tjetër, dhe duke qenë se viktimat e dhunës në shumicën e rasteve i përkasin grupeve vulnerabël, nuk mundëson parandalimin e rreziku për të rënë në varfëri. Nisur nga janari 2022, hyn në fuqi vendimi për trefishimin e masës së ndihmës për disa kategori të veçanta, përfshirë viktimat e dhunës në familje. Edhe pse ky vendim, sipas grupeve të interesit, është pritur mirë nga kategoritë e targetuara, masa mbetet poshtë nivelit të varfërisë për një individ.

Në mungesë të qartësisë dhe kuptimit të njëjtë të procesit, rishikimi i përshtatshmërisë së përfitimeve të ndihmës sociale duhet të shtrihet edhe në kategoritë e veçanta. Më 28 maj 2021, MSHMS hartoi një urdhër (nr. 269) për ngritjen e një grupi ndërinstytucional pune për vlerësimin e përfitimeve të ndihmës ekonomike bazuar në të dhënat nga AANJ, nivelin e pagës minimale dhe informacione të tjera përkatëse. Grupi i punës kryesohet nga Drejtori i Përgjithshëm i MSHMS dhe përbëhet nga përfaqësues të Shërbimit Social Shtetëror, të MSHMS, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe INSTAT. Aktualisht me mbështetjen e Bankës Botërore, është përfunduar udhërrëfyese për përmirësimin e performancës së NE në targetim dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël dhe MSHMS duhet të planifikojë zbatimin e tij deri në fund të vitit 2024. Disa nga hapat kryesorë të përfshirë tek udhërrëfyese janë: (1) analiza e performancës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe (2) propozimi i një mekanizmi për përditësimin periodik të nivelit të përfitimit të ndihmës ekonomike; (3) konsultimi publik për të dakordësuar mbi zgjidhjet më të përshtatshme të rekomanduara; (4) rishikimi i VKM-ve që lidhen me ndihmën ekonomike; (5) lidhja me procesin buxhetor; (6) procesi i vlerësimit të zbatimit të ndihmës sociale; (7) përditësimi i Sistemit Informativ të Menaxhimit për të pasqyruar ndryshimet; (8) përfundimi i procesit të vlerësimit të zbatimit të ndihmës sociale (kushtëzuar nga disponueshmëria e fondeve); (9) fushata komunikimi; dhe (10) aplikimi i mekanizmit për të përditësuar rregullisht nivelin e përfitimit të NE. Nisur nga sfidat e identifikuara, vendimet arbitrare të rritjes së masës së ndihmës ekonomike për disa nga kategoritë e veçanta në vitin 2022, sugjerojmë që procesi i vlerësimit dhe rishikimit të masës së NE të shtrihet dhe për kategoritë e veçanta.

Rishikimi i programit të NE duhet të përfshijë dhe efektivitetin e formulës së pikëzimit duke u bazuar në rezultatet AANJ 2019, INSTAT, për llogaritjen e treguesve të varfërisë për të përmirësuar vlerën e përfitimeve, e duke marrë parasysh dhe burime të tjera të dhënash për të forcuar treguesit e përdorur dhe harmonizuar me treguesit demografikë dhe nivelin e jetesës në vend. Së fundi, **sistemi i mbrojtjes sociale duhet të marrë parasysh dhe krizat duke u përshtatur për t’iu përgjigjur nevojave të reja.**

3.5. Riintegrimi social dhe burimet

3.5.1. Shpërndarja e burimeve në programet e mbrojtjes sociale

Alokimet buxhetore që mbulojnë sigurimin e mbrojtjes sociale përmes Ndihmës Ekonomike dhe pagesave për Personat me Aftësi të Kufizuar kanë reflektuar situatat e vështira që ka kaluar vendi, sidomos ato të lidhura me përballimin e pandemisë Covid-19. Kështu, alokimet buxhetore të lidhura me ndihmën ekonomike shënuan një rritje prej 27.9% në vitin 2020 përkundërt një viti më parë. Ato kanë vazhduar të rriten me 17.9% në vitin 2021 në raport me vitin 2020, ndërsa tkurren me 2.7% në parashikimet buxhetore të vitit 2022.

PAK u rrit me 17% në vitin 2020 kundërt vitit 2019, por shënoi rënie me 7.4% në 2021-shin krahasuar me alokimin buxhetor të vitit 2020. Ky alokim buxhetor vijon të jetë me rënie prej 2.3% në parashikimet e bëra në buxhetin e vitit 2022 përkundër pritshmërive për 2021.

Tabela 5: Alokimet buxhetore të ndihmës ekonomike dhe PAK, peshat e tyre në buxhet dhe PBB

Lloji i Pagesës	Alokimet Buxhetore										
	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	
a) Ndihma ekonomike	3,843	4,869	4,919	4,585	4,912	4,361	4,250	5,435	6,411	6,240	
b) Pagine PAK	15,558	19,048	15,999	15,402	15,740	16,304	15,860	18,560	17,179	16,790	
a) NE % budget	0,97	1,07	1,08	1,05	1,06	0,88	0,86	1,01	1,05	0,92	
% of PBB	0,28	0,35	0,34	0,31	0,32	0,26	0,25	0,33	0,36	0,33	
b) PAK % budget	3,94	4,17	3,50	3,55	3,41	3,28	3,22	3,46	2,82	2,48	
% of PBB	1,15	1,36	1,11	1,04	1,01	0,99	0,94	1,15	0,97	0,89	
NE + PAK (a+b)	19,401	23,917	20,918	19,987	20,652	20,665	20,110	23,995	23,590	23,030	
NE + PAK % of budget	4,91	5,24	4,58	4,60	4,47	4,16	4,08	4,47	3,87	3,40	
% of PBB	1,43	1,71	1,45	1,35	1,33	1,25	1,19	1,48	1,33	1,22	
Total State Budget	394,051	456,404	456,437	433,697	461,410	497,069	491,897	536,279	610,069	676,694	
GDP	1,350,555	1,393,540	1,441,644	1,475,251	1,552,868	1,647,625	1,691,727	1,617,541	1,769,258	1,876,351	

Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Pavarësisht ndryshimeve të vërejtura në alokimet buxhetore për NE, raporti i saj ndaj PBB tregon ndryshime shumë të vogla nga 0.33% në 0.36% e PBB; ndërsa edhe pse parashikohen rritje në masën e NE për vitin 2022 ky raport përsëri mbetet në nivelin e 0.33% të PBB-së; kjo tregon për një situatë statike përsa i përket dinamikave të NE-së pavarësisht atyre të vërejtura me PBB, e cila u tkurr në vitin 2020, ndërsa pritet të rikuperojë në 2021. Ndryshe, paraqitet situata në lidhje me PAK ku dinamikat në rritje apo rënie të alokimeve buxhetore reflektohen edhe në raport me PBB-në për periudhën 2019 - 2022.

3.5.2. Kostimi i shërbimeve të ri-integrimit të Viktimave të Dhunës në Familje

Ndërsa masat e pagesave për NE, përfshi edhe viktimat e dhunës në familje, mbeten arbitrare, ka një përpjekje për të kostuar shërbimet që duhet të përfitojë një viktimë e dhunës në familje sipas një “Modeli të riintegrimit për të Mbijetuarit e dhunës me bazë gjinore», kryer nga organizata «Të ndryshëm por të Barabartë». Sipas këtij studimi, riintegrimi i plotë i viktimës së dhunës kalon në tri faza: fillestare, afatmesme dhe afatgjatë, secila prej të cilave parashikon shërbime të ndryshme. Asistenca Fillestare - ndërhyrja në situatë krize - e cila parashikohet të zgjasë për një periudhë 6 mujore, ka një kosto prej 503,146 lekë. Asistenca afatmesme - fazë tranzitore që përfshin jetesë gjysmë të pavarur - parashikohet të zgjasë për një periudhë 1 vjeçare, ka një kosto prej 351,347 lekë; dhe Asistenca afatgjatë - riintegrimi dhe përfshirja sociale - parashikohet se mund të zgjasë deri në 3 vjet - vlerësohet me një kosto prej 268,312 lekë (UN Women, Draft Raport -nëntor, 2021).

Qeveria ka ndërmarrë disa hapa me synimin për të përmirësuar performancën e ndihmës ekonomike. Për këtë parashikohet që deri në fund të vitit 2024 të kryhet: a) analiza e performancës së NE; krijimi i një mekanizmi për të përditësuar rregullisht masën e NE; vlerësimi i zbatimit të Strategjisë së daljes nga NE; ndryshime legjislative nëse nevojiten nga analizat e mësipërme; përditësim i sistemit MIS, dhe të tjera veprime sipas nevojës. Ndërsa ky proces pritet të fillojë, Qeveria ka marrë vendim që duke filluar nga viti 2022 të rrisë masën e pagesave të ndihmës ekonomike për të gjitha kategoritë në nevojë.

Kjo vendim-marrje e Qeverisë parashikon të trefishojë masën e pagesës për viktimat e dhunës në familje nga 3,000 lekë në 9,000 lekë. Këto rritje mbeten të pabazuara në ndonjë studim, vlerësim apo referencë. Nga ana tjetër, Qeveria, për të ndërprerë varësinë nga NE, synon që të krijojë incentiva për bizneset që ata të punësojnë individë përfitues të NE duke bashkëfinancuar pagën në masën e NE që përfiton individi. Në takim ku u lajmërua ky synim i qeverisë Kryeministri Rama⁴¹ u shpreh se NE është vetëm sa për të mbajtur frymën gjallë.

41 <https://www.gazeta-shqip.com/biznes/bisedime-me-biznesin-rama-tregon-skemen-si-do-te-punesohen-personat-ne-nd-i1159752>

- **Përmirësimi i informacionit dhe aksesit në programet e mbrojtjes sociale**

Informacioni mbi të drejtat dhe mundësitë e mbështetjes që ofrohen për secilën kategori është i pamjaftueshëm. Antarët e mekanizmit referues, njësitë vendore, si dhe administratorët shoqërorë dhe ekipi i Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve, duhet të përfshijnë në planin e tyre të punës aktivitete të harmonizuara të komunikimit periodik përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit e informimit mbi pagesat cash (NE dhe PAK), programet e mbrojtjes sociale dhe ku duhet të drejtohen qytetarët në nevojë për mbështetje.

Njësitë vendore duhet të publikojnë në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë listën e plotë të pagesave të asistencës sociale dhe të përfitimeve të tjera të parashikuara nga legjislacioni i zbatueshëm në fuqi për kategoritë e përfituesve të asistencës sociale, përfshirë VDF. Informacioni mbi rregullat e përfitimit duhet të mundësohet përmes pushtetit vendor të jetë lehtësisht i aksesueshëm në çdo zyrë vendore, si dhe në hapësira të tjera publike, në bashkëpunim me anëtarët e mekanizmit të referimit dhe OJF-të.

Natyrisht, zbatimi i aktiviteteve që synojnë përmirësimin e informacionit dhe aksesit kërkon burime të alokuara në kohë në buxhetet vendore të institucioneve, përfshirë kosto të transportit për të mundësuar vizita në komunitet, duke siguruar identifikimin dhe përfshirjen e personave në varfëri ekstreme e me vulnerabilitete të shumëfishta.

Përdorimi i regjistrit elektronik (MIS NE) për analizën e profilit të aplikuesve dhe përfituesve si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të dhënave të këtij regjistri. Regjistri elektronik i NE përmban informacione me vlerë mbi situatën sociale dhe ekonomike të aplikantëve dhe përfituesve. Analiza e mëtejshme e periodike e këtyre të dhënave mund të shërbejë më mirë për të kuptuar nevojat e individëve e familjeve në nevojë si dhe për të informuar politikëbërjen dhe planifikimin më të mirë të ndërhyrjeve integruese në bashku me punonjësit socialë. Për individët e familjet që nuk kanë të ardhura të rregullta mund të kryhen hulumtime të mëtejshme, rezultatet e të cilave mund të ndihmojnë në rishikimin e regjistrit elektronik.

- **Forcimi i kapaciteteve të strukturave publike**

Është e nevojshme të hartohet një **plan për ngritjen e kapaciteteve për të gjithë bashkitë** mbi të drejtat dhe udhëzimet lidhur me aksesin dhe aplikimin në pagesat e asistencës sociale të kategorive të ndryshme, bazuar në raste konkrete, për të ilustruar hapat që duhen ndërmarrë, mbështetur në kuadrin ligjor. Kjo do ndihmonte në krijimin e njohurive të njëjta dhe rritjen e qartësisë mbi pranueshmërinë, aplikimin dhe proceset e lidhura me përfitimin e pagesave të asistencës sociale. Ky aktivitet rekomandohet të ndodhë pasi të jenë hartuar ndryshimet e nevojshme ligjore duke adresuar sfidat e identifikuara, si e drejta e përfitimit, llojet e programeve përfituese dhe pagesat paralele.

Më tej, **duhen fuqizuar kapacitetet e një sërë aktorësh, pjesë e sistemit të asistencës sociale**, ofrues shërbimesh, publikë e jo-publikë (OJF), si dhe institucionet e tjera, pjesë të mekanizmit të referimit. Zyrat e Ndihmës Ligjore duhen përfshirë në aktivitete informuese dhe fuqizuese të kapaciteteve mbi të drejtat dhe aksesin e grupeve në sistemin e mbrojtjes sociale.

Rritja e kapaciteteve duhet të zbatohet periodikisht për të gjitha strukturat. Në këtë mënyrë, do të sigurohej që stafet përgjegjëse të jenë të informuar dhe të përditësuar me legjislacionin përkatës dhe krijimin e praktikave të punës që sigurojnë reflektimin ligjor mbi aplikimin në sistemin elektronik (Regjistrin Elektronik Kombëtar) dhe zbatimin e sistemit. Diskutimi mbi praktikat e ndryshme në menaxhimin e programit të NE në nivel vendor duhet të jetë aktivitet periodik nën drejtimin e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social. Raportet mbi praktikat e sfidat, duhet të shërbejnë për të ushqyer politikë-bërjen në mënyrë që qasja e mbrojtjes sociale të jetë reflektive duke siguruar përmirësimin e garantimin e aksesit të barabartë, të informuar e pa diskriminim, për të gjithë individët e familjet në nevojë në programet e mbrojtjes sociale.

Është e nevojshme **të fuqizohet bashkëpunimi mes policisë dhe koordinorit të dhunës që në momentin e vlerësimit të riskut**, në mënyrë që sistemi të vihet në lëvizje, dhe të maksimizohet aksesin i individëve të kualifikueshëm në sistemin e asistencës sociale.

Gjithashtu, mbetet i nevojshëm **sigurimi i burimeve njerëzore në nivel vendor për të mundësuar në mënyrë efektive kryerjen e verifikimeve** të aplikantëve/përfituesve të programit. Shmangia e abuzivizmit me skemën e mbrojtjes nuk mund të jetë një peshë që duhet të rëndojë individët e familjet që kanë nevojë për mbështetje; bashkitë kanë nevojë për një numër të përshtatshëm punonjësish socialë në raport me popullsinë dhe ngarkesën e punës që kanë këto struktura.

- **Adresimi i sfidave që lidhen me proceset e aksesit dhe zbatimit të pagesave të ndihmës ekonomike**

Qëllimi programit të ndihmës ekonomike është zbutja e varfërisë dhe garantimi i aksesit të kategorisë së përfituesve në mbrojtjen sociale duke adresuar vulnerabilitetet e shumëfishta të tyre, përmes mbështetjes me të ardhura dhe shërbime. Mungesa e aksesit të barabartë e trajtimit tërësor të këtyre nevojave çënon të drejtën e individëve dhe familjeve për të përfituar nga kjo e drejtë si dhe suksesin e programit të hartuar për këtë qëllim. Nga diskutimet me grupe të ndryshme për qëllimin e këtij vlerësimi, u identifikuan disa sfida që çënojnë aksesin e individëve me status të veçantë dhe familjeve në nevojë, si:

- mungesa e informacionit dhe kuptimit të qartë të të drejtës, kriterëve të pranueshmërisë dhe aplikimit për të përfituar pagesa të NE, si nga ana e administratorëve të sistemit dhe kategorive në nevojë;
- sfida logjistike që lidhen me aksesin si mobiliteti e kostot e transportit, vështirësia për t'u paraqitur personalisht në bashkinë e origjinës (në rastin e viktimave të dhunës në familje);
- sfida që lidhen me paragjykimin dhe stigmatizimin e kategorive në nevojë, sidomos viktimave të dhunës në familje, PAK e grupe të tjera të marginalizuara ndikojnë në dekurajimin e aplikantëve e në besimin e tyre ndaj institucioneve.
- si dhe sfidat lidhur me kuptimin dhe zbatimin e kuadrit rregullator, përfshirë procedurat e UM, të diskutuara në vijim.

Studimi identifikoi një sërë sfidash e rekomandimesh lidhur me proceset për të përfiturat nga pagesat e Asistencës Sociale (NE dhe PAK), konkretisht:

Mundësimi i aplikimit të **viktimitave të dhunës të regjistruar si rezidentë në bashki tjetër; ofrimi NE për viktimat e dhunës, si kategori të veçanta, që në strehëza (publike apo jo-publike). Të ndryshohet neni 11 pika 'dh' e Ligjit për Asistencën Sociale (Ligji 597/2019).**

Gjithashtu, është i nevojshëm përmirësimi i sistemit që të legjitimojë pagesat e **NE si viktimitave të dhunës në familje edhe mbi bazën e urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes**; konkretisht, të pranohen edhe vendime të cilat kanë vetëm datë dhe nuk kanë numër për efekte identifikimi të urdhrit përkatës. Më tej, duke patur parasysh vonesat për zbardhjen e dorëzimit të UM nga gjykatat, pranimi i UMM është edhe më i rëndësishëm për sigurimin e mbështetjes me pagesat NE për viktimat e dhunës në familje për këtë kategori. Në rastin e urdhrave të pazbardhur të krijohet praktika detyruese bazuar në dispozitat ligjore⁴² përkatëse të KPC.

Sistemi nuk ofron fleksibilitet përtej periudhës së datave 1-10 të çdo muaji, për të adresuar aplikime të rasteve emergjente. **MSHMS duhet të shqyrtojë mundësinë e ofrimit të pagesave të NE për viktimat e dhunës në familje për rastet emergjente**, qoftë edhe përmes sistemit apo buxhetit (6%) të administruar nga bashkitë për NE.

Verifikimet konfirmojnë zbatimin e praktikave të ndryshme lidhur me aplikimin në skemën e NE. Viktimat e dhunës në familje dhe PAK mund të aplikojnë njëkohësisht për pagesat për ndihmë ekonomike si VDF dhe si individ/pjesëtar i familjes në nevojë. Nuk ka një kuptim të drejtë të legjislacionit, dhe zbatim të saktë të tij, nga pikëpamja strikte ligjore. Në këto kushte, janë identifikuar praktika jo të njëjta, kryesisht për rastin e viktimitave të dhunës, ku disa bashki lejojnë aplikimin për mbështetje shtesë si familje në nevojë dhe të tjera jo. Kryesisht, sikurse u konfirmua nga intervistat e ndryshme, në rastet

42 Kodi i Procedurës Civile, Neni 308: (Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr. 8812, datë 17.5.2001 dhe paragrafi i dytë me ligjin nr. 38/2017, datë 30.3.2017) *“Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën “kundër” dhe nënshkruan vendimin. Gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit, duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari jo më vonë se njëzet ditë ose të shtyjë shpalljen e arsyetuar të vendimit, deri në njëzet ditë. Arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër”.*

kur viktimat e dhunës në familje janë përfituese si familje në nevojë dhe si kategori e veçantë VDF, masa e përfitimit për to zbritet e llogaritet vetëm për fëmijët apo anëtarët e tjerë në varësi.

Sistemi i mbrojtjes sociale duhet të mishërojë, edhe në praktikë, një qasje tërësore të trajtimit të vulnerabilitetit. Sikurse njihet dhe në dokumente politike të sektorit, grupet në nevojë kanë vulnerabilitete të shumëfishta në të cilat gjenden pa zgjedhjen e tyre, ndaj **sistemi nuk mund të jetë përjashtues, por të sigurojë një qasje përfshirëse për sigurimin e aksesit në tërë programet që adresojnë situata të ndryshme**, qoftë dhunën në familje, aftësinë e kufizuar apo varfërinë. **Është e nevojshme të bëhen ndryshime ligjore përkatëse për të qartësuar, në veçanti, përmbajtjen e nenit 12 pika 6 të Ligjit për Asistencën Sociale.** Po kështu, është e nevojshme të udhëzohen strukturat vendore mbi zbatueshmërinë e ligjit lidhur me pagesat paralele në mënyrë që kategoritë e veçanta të mund të përfitojnë nga masat e ndryshme të mbrojtjes që ofrohen nga sistemi.

Administratorët shoqërorë, duhet të nxiten të kryejnë vlerësimin socio-ekonomik dhe verifikimet e nevojshme sipas përcaktimeve ligjore, për aplikimet e kategorive të veçanta si individë/familje në nevojë. Zbatimi i hapave sipas parashikimeve ligjore mund të sigurojë që ndihma të shkojë te më të varfërit, pa cenuar të drejtën e individëve për të aplikuar.

Së fundi, lidhur me procesin, sikurse është theksuar dhe në raporte apo studime të mëparshme e validuar edhe nga grupet e interesit, ka raste kur, sistemi (Regjistri Elektronik Kombëtar) nuk lejon përfshirjen e aplikantëve, përfshirë nga kategoritë e veçanta, që nuk arrijnë të kalojnë vlerësimin përmes formulës së pikëzuar edhe pse në kushte tejet të vështira MSHMS duhet të shqyrtojë **mekanizmat alternative për të adresuar gjykimin e sistemit**, sidomos për raste emergjente si dhuna në familje. **Proaktiviteti i strukturave vendore**, koordinatorëve të dhunës, administratorëve e punonjësve socialë mund të luajë një rol të rëndësishëm në identifikimin e nxitjen për t'iu drejtuar programeve të mbrojtjes sociale që adresojnë individët e familjeve në nevojë.

Aplikimi online përmes platformës e-albania mund të jetë një alternativë për disa kategori si VDF apo PAK, duke ndihmuar në adresimin e disa prej sfidave që këto grupe ndeshin. Ndoshta aplikimi online mund të lejohet si opsion duke e kombinuar me verifikime në familje. Natyrisht, individët pa akses në

teknologji apo që kanë nevojë për ndihmë me procesin e aplikimit elektronik duhet ta gjejnë këtë mbështetje pranë strukturave vendore.

- **Përmbledhje e ndryshimeve të mundshme ligjore**

Të lejohen shprehimisht pagesat paralele që legjislacioni ndalon për statuse të caktuara të ndryshme juridike të të njëjtit person, si VDF, PAK, individ/pjesëtar i familjes në nevojë, etj., për pagesa të asistencës sociale (Ndhmë Ekonomike, PAK, etj.) dhe përfitime shtesë paralele në përmbushje të të drejtave dhe standardeve kushtetuese dhe ndërkombëtare, mbi të gjitha, për jetë dinjitoze. Pagesat paralele të lejohen mbi bazën e parimit që duhet të sigurohet mbrojtje sociale për çdo status i cili krijon pasoja të veçanta dhe të shumëfishta për personat që kategorizohen njëkohësisht si përfitues të mbrojtjes sociale e shumë statuseve ligjore në nevojë e vulnerabël.

Po kështu, **të ndryshohen dispozita të caktuara të legjislacionit në fuqi për të mundësuar jo vetëm pagesa paralele brenda skemës të ndihmës ekonomike por, edhe përfitime në natyrë e shërbime paralele.** Për këtë qëllim, të rishikohet neni 11 pika 'dh' e Ligjit për Asistencën Sociale.

Të parashikohen kritere e metoda të besueshme për llogaritjen e minimumit jetik për qëllime të lejimit të pagesave paralele. Konkretisht, të bëhet ndryshim në Ligjin për Asistencën Sociale ku të përfshihen kritere të përcaktimit të minimumit jetik për qëllime të plotësimit të këtij minimumi nëpërmjet pagesave paralele të ndihmës ekonomike, pavarësisht nga lloji, për të përmbushur në menyrë efektive të paktën standardin e minimumit jetik.

Të thjeshtëzohet kategorizimi i individëve dhe familjeve në nevojë e vulnerabël, përfshirë por pa u kufizuar në VDF, si dhe vetë skema e ndihmës ekonomike, duke synuar aksesin efektiv të kategorive në nevojë e vulnerabël për shkak të komplikimit dhe/ose moskuptimit të skemës së ndihmës ekonomike (të pagesave dhe përfitimeve të kësaj skeme) dhe të kujdesit social.

Për mbështetjen dhe mbrojtjen efektive të VDF me pagesat e skemës së ndihmës ekonomike, **rekomandohet ndryshimi ligjor i nenit 12 pika 6 në Ligjin për Asistencën Sociale:** më konkretisht, të ndryshohet formulimi i pikës 6 në nenin 12 për të lejuar shprehimisht pagesat e ndihmës ekonomike për

individët dhe pjesëtarët/familjet në nevojë dhe pagesat për VDF dhe pagesat PAK në rastet kur i njëjti individ kualifikohet si kategori përfituese për secilën nga kategoritë që përfitojnë nga pagesat dhe ndihmës ekonomike.

Të hartohet akt nënligjor/udhëzim i veçantë për administratorin shoqëror me synimin për të shmangur diskrecionin në përfitimin e pagesave dhe përfitimeve të ndihmës ekonomike. Kjo të pararendet me ndryshim ligjor në Ligjin për Asistencën Sociale (neni 23 dhe neni 32).

Pas ndryshimeve ligjore, të rishikohet formulari dhe Regjistri Elektronik Kombëtar që sistemi të pasqyrojë dhe verifikojë saktësisht kërkesat e ligjit në fuqi. Më tej, të bëhen ndryshime në lidhje me integrimin ligjor të Regjistratit Elektronik të NE dhe Regjistratit Elektronik të PAK në Regjistrin Elektronik Kombëtar. Integrimi të synojë mundësimin e pagesave paralele pas ndryshimeve/saktësimeve përkatëse ligjore.

Në përgjithësi, shumica e akteve ligjore dhe nënligjore përkatëse janë miratuar para viteve 2000 dhe vlerësohet se nuk janë në plotësisht në përputhje me standardet e miratuara në vijim nga vendi ynë. Për këtë arsye, rekomandohet rishikimi i legjislacionit veçanërisht, në fushën mbrojtjes sociale për Personat me Aftësi të Kufizuara⁴³.

- **Integrimi i aktiviteteve informuese dhe advokimit në planet vjetore të punës**

Kontaktet periodike me komunitetet do të lehtësonin dhe shpërndarjen e informacionit mbi procesin e aplikimit, përfitimin dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Administratorët shoqërorë duhet të ndajnë informacionin mbi kushtet e kualifikimit, rregullat e procesit të aplikimeve dhe mbështetjen paralele që mund të ofrohet, qoftë përmes ndihmës ekonomike, nëse kualifikohen në më shumë se një program, por edhe shërbimeve.

Duhet të ofrohet informacion lehtësisht i kuptueshëm mbi aplikimin dhe aksesin e mbështetjes në çdo zyrë vendore e hapësira të tjera publike, përfshirë mediat sociale. Materialet promovuese mund të ndahen përmes

⁴³ Domosdoshmëria për reformimin e legjislacionit PAK ka lindur me ratifikimin nga Shqipëria të CRPD në vitin 2012.

medias sociale e faqeve të internetit të institucioneve të ndryshme.

Vlerësimi dhe rishikimi i masës së ndihmës ekonomike Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale (KE, 2021, parimi 14), bën thirrje për skema të mbështetjes me të ardhurave minimale që sigurojnë një jetë dinjitoze në të gjitha fazat e jetës dhe akses efektiv në mallra e shërbime. Më tej ky parim thekson se për ata që mund të punojnë, përfitimet minimale të të ardhurave duhet të kombinohen me stimuj për riintegrim në tregun e punës. Një nga aktivitetet e Planit të Veprimit (2021-2030) të Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale, për 2022 është hartimi i një propozimi për Rekomandim të Këshillit të Evropës mbi të ardhurat minimale.

Strukturat vendore duhet të informohen mbi programet dhe masën e përfitimit që u takon kategorive të veçanta aplikuese si individë/pjestare të familjes në nevojë, duke garantuar **shmangien e zbritjes së masës për viktimën e dhunës** e llogaritjen e masës vetëm për fëmijët apo anëtarët e tjerë në varësi, të cilët nuk përfshihen në urdhrin e mbrojtjes.

Shuma e pagesës së NE për individë/pjesëtarë të familjes në nevojë është përcaktuar me anë të një udhëzimi të ministrisë përgjegjëse për mbrojtjen sociale⁴⁴. **Masa e NE nuk reflekton asnjë lidhje me koston minimale të jetesës.** Për më tepër, sistemi duket se llogarit përfitimet si familje në nevojë duke u bazuar në strukturën e familjes dhe të ardhurat e deklaruara e, si rrjedhojë, familjet e kualifikuara me strukturë të njëjtë **marrin të njëjtën masë të ndihmës ekonomike edhe nëse nivelet e tyre aktuale të të ardhurave mund të jenë të ndryshme.** Procesi i rishikimit të programit të NE duhet të përfshijë dhe rishikimin e formularit të vlerësimit socio-ekonomik.

Është e rëndësishme të organizohen **konsultime mbi përshtatshmërinë e NE në vendin tonë**, sidomos në kuadër të zbatimit të udhërrëfyesit të hartuar për këtë qëllim. Pjesë e diskutimeve duhet të jetë dhe mundësimi i lidhjes mes masës së NE me nivelin e varfërisë apo me pagën minimale. **Mungesa e një reference nxit arbitraritetin e cënon synimin e zbutjes së varfërisë e sigurimit të një jetë dinjitoze që asnjë të mos mbetet pas.** Në shumë vende të BE-së, masa e përfitimeve përcaktohen kundrejt pagës minimale (KE,

44 Udhëzimi 8/2014 i Ministrisë së Mirëqënies Social dhe Rinisë (bazuar tek VKM 904.2012) i cili vendos përfitimet mujore në 1800 lekë për kreun e familjes, 1260 lekë për anëtarët e tjerë të rritur dhe 900 lekë për anëtarët e mitur të familjes.

2019). Përcaktimi i nivelit të të ardhurave minimale në lidhje/në raport me pagën minimale, lejon që të ardhurat minimale të përafrohen me zhvillimin ekonomik të vendit në mënyrë më transparente (KE, 2019). Duhet të mbahet në konsideratë se paga minimale ka të bëjë me individët, ndërsa të ardhurat minimale kanë të bëjnë kryesisht me familjet. Në kontekstin global ka qasjeve të ndryshme për përcaktimet e pagës minimale dhe ekziston një ndjeshmëri politike mbi diferencën e pranueshme midis nivelit të pagës minimale dhe të ardhurave minimale. NE dhe përfitimet e tjera duhet të bëhen pjesë e indeksimit periodik, bashkë me pagat. Këto diskutime mund të nxiten dhe në kuadrin e rishikimit të përshtatshmërisë së masës ekonomike.

Vendimi i fundit i Këshillit të Ministrave (VKM nr. 868, datë 29.12.2021) për rritjen e masës së përfitimit për disa nga kategoritë e veçanta, përfshirë viktimat e dhunës në familje dhe me 10% për të gjithë familjet në nevojë përfituese të **NE, është gjithësesi një hap pozitiv. Llogaritja e masës së ndihmës duhet të mbështetet në vlerësime të plota e mbi analizë të thelluar bazuar në minimumin jetik, e nevojat reale të një familjeje.** Si rregull i përgjithshëm, **ndryshimet në skemën e përfitimeve duhet të sigurojnë koherencë me qasjen dhe programet e mbrojtjes sociale dhe standardet ndërkombëtare të pranuar me konventa nga Shqipëria dhe të drejtat e standardet kushtetuese.**

Matja e ndikimit të masave për zbutjen e varfërisë duhet të jetë pjesë integrale e veprimeve në zbatim të kuadrit politik të mbrojtjes sociale. Suksesi i masave nuk mund të vlerësohet vetëm përmes një rritjeje të masës së NE të pa mbështetur në evidenca, por përmes matjes periodike të ndikimit dhe analizave të tjera lidhur me zhvillimin ekonomik dhe nivelin e jetesës së individëve me nevoja të veçanta e familjeve në nevojë. Rezultatet e këtyre analizave duhet të ushqejnë sistematikisht politikëbërjen.

5. Referencat

Banka Botërore (2021a) World Bank Regular Economic Report, Subdued Recovery, Spring 2021.

Banka Botërore (2021b) World Bank Western Balkans Regional Economic Report, No. 20, Fall 2021: Greening the Recovery.

INSTAT, Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2019.

INSTAT, Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës 2020.

Komisioni Evropian (2019) Përmbledhje e diskutimeve mbi dialogun e strukturuar për zbatimin e të ardhurave minimale, zhvilluar në Athinë në 2 dhe 3 korrik 2019, organizuar nga Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian (2019), Shtylla Evropiane të të Drejtave Sociale dhe Plani i Veprimit (2021-2030).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2019) Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020-2023, miratuar me VKM Nr. 866 datë 24.12.2019 (FZ 184 datë 31.12.2019).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021-2024) Udhërrëfytyesi për përmirësimin e performancës së NE në targetim dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021) Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, miratuar me VKM Nr. 276, datë 12.5.2021 (FZ 75 datë 20.05.2021).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2021) Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, miratuar me VKM Nr. 400, datë 30.06.2021 (FZ 112 datë 15.07.2021).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Urdhër nr.269/2021 “Për ngritjen e një grupi ndërinstitucional pune për vlerësimin e përfitimeve të ndihmës ekonomike bazuar në të dhënat nga SILC, nivelin e pagës minimale dhe informacione të tjera përkatëse”.

UN Women (nëntor 2021) (Draft) Raport mbi Modeli i riintegrit për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore.

UNICEF (2019) Mapping Social Protections transfers to poor households in Albania <https://www.unicef.org/albania/media/3161/file/Mapping%20Social%20Protection%20Transfers.pdf>.

o Ligje dhe vendime

Ligji nr.8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbrit”, i ndryshuar (FZ_13 datë 07.05.1996).

Ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e Invalidit”, i ndryshuar (FZ 19 datë 31.12.1994).

Ligji nr.8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e Invalidit Paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar (FZ 20 datë 18.07.2000).

Ligji nr.10129 datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile”, i ndryshuar (FZ 85 datë 21.06.2009).

Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” (FZ 113 datë 01.08.2019).

Ligj nr.7511, datë 8.8.1991 “Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore” (FZ 6 datë 29.08.1991).

Ligji nr.8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20 datë 12.08.1996).

VKM nr.597, datë 04. 09. 2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit, dhe masës mujore të përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të Fondit Shtesë mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike”. (FZ 123 datë 09.09.2019).

VKM nr.85, datë 10.02.2021 “Për një shtesë në vendimin nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (FZ 24 datë 16.02.2021).

VKM nr.868, datë 29.12.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (FZ 206 datë 31.12.2021).

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 34/2012 (https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_përfundimtare_100_1.php)

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.33/2010

(https://www.gjk.gov.al/web/Vendime_përfundimtare_100_1.php)

6. / Shtojcat /

Shtojca 1: Lista e institucioneve të përfshira në intervista e fokus grupe

Nr	Institucioni
Institucione Publike	
1	Avokati i Popullit
2	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
3	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
4	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Ministria e Drejtësisë
5	Shërbimi Social Shtetëror
6	Drejtoritë Rajonale Korçë e Dibër
7	Bashkitë: Mat, Korçë, Pogradec e Tiranë
8	Zyra për Ndhmë Juridike Falas, Shkodër
Organizata të Shoqërisë Civile	
9	Unë Gruaja, Pogradec
10	Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (Linja Kombëtare), Tiranë
11	Strehëza për Grate dhe Vajza – Tiranë,,
12	Gruaja te Gruaja, Shkodër
13	Qendra Liliun, Tiranë
14	Forumi i Gruas, Elbasan
15	Qendra Vatra, Vlorë

Shtojca 2: Tabela përmbledhëse ligjore

Lloji i pagesës ose përfitimit	Aktet Ligjore dhe nënligjore	Parashikimi Ligjor	Kategoritë përfituese	Përfitimet
Ndihma Ekonomike (NE)	<p>1. Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>2. VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike”, e ndryshuar me VKM nr. 85, datë 10.2.2021</p> <p>“Për një Shtesë në Vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të</p>	<p>Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”</p> <p>Neni 7</p> <p>Përftuesit e ndihmës ekonomike</p> <p>Përftuesit e ndihmës ekonomike janë:</p> <p>a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;</p> <p>b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;</p> <p>c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;</p> <p>ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;</p> <p>d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.</p>	<p>1. Familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;</p> <p>2. Jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;</p> <p>3. Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;</p> <p>4. Viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;</p>	<p>1. Pagesë në formën e një shpërblimi mujor në lekë:</p> <p>- Masa e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 për qind e masës së pensionit social dhe e indeksuar.</p> <p>- Masa e ndihmës ekonomike, në muaj, për prindërit e fëmijëve të</p>

<p>Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”</p> <p>3. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar</p>	<p>Neni 12 Pagesa e ndihmës ekonomike</p> <p>1. Ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Kufizimi në kohë i ndihmës ekonomike bëhet sipas përcaktimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>2. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.</p> <p>3. Familjet dhe individët në nevojë kanë të drejtë të marrin përfitime në natyrë. Mënyra e përfitimeve në natyrë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>4. Fëmijët e familjes në nevojë, të cilët përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe jetimët, të cilët nuk janë në institucione që ndjekin arsimin e detyrueshëm, sipas legjislationit në fuqi për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, marrin një pagesë shtesë, deri në mbarimin e arsimit të detyrueshëm, në masën e përcaktuar me vendim nga Këshilli i Ministrave.</p>	<p>5. Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore</p>	<p>lindur është, si më poshtë vijon: a) Trinjakë 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo fëmijë; b) Katërnjakë 4 000 (katër mijë) lekë, për çdo fëmijë; c) Pesënjakë 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo fëmijë.</p> <p>- Masa e ndihmës ekonomike për viktimat e trafikimit është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.</p> <p>- Masa e ndihmës ekonomike për çdo viktimë të dhunës në marrëdhëniet familjare që nuk trajtohet në institucionet</p>
--	--	--	--

5. Fëmijët e familjes në nevojë si dhe jetimët, që nuk janë në institucione, të cilët janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një pagesë shtesë, për çdo vaksinë të kryer, në masën e përcaktuar me vendim nga Këshilli i Ministrave.

6. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, sipas përcaktimeve në nenin 7, të këtij ligji, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

7. Anëtarit të familjes në nevojë, që, me vendim të formës së prerë të gjykatës, vuan dënimin me heqje lirie ose që trajtohet me mjekim të detyruar me vendim gjykatë, në institucionet mjekësore të posaçme, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

8. Procedura, dokumentacioni dhe masa mujore e përfitimit të ndihmës ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Masa e ndihmës ekonomike, për familjet në nevojë, përcaktohet sipas strukturës së familjes dhe shkon deri në 150 përqind e masës së pensionit social dhe e indeksuar.

e përkujdesjes shoqërore, të përcaktuar në urdhrin e mbrojtjes apo urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

- Masa e ndihmës ekonomike për çdo jetim është 3 000 (tre mijë) lekë në muaj.

- Anëtarët e familjes, fëmijë/jetimet që nuk janë në institucione për të cilët vërtetohet që ndjekin arsimin bazë deri në moshën 16 vjeç, marrin një shtesë në masën 300

Neni 11

Personat jopërfytyes

Nga ky ligj nuk përfitojnë:

...dh) personat që trajtohen në institucionet e përkujdesjes rezidenciale publike, të financuara nga fondet e buxhetit të shtetit, për masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për aftësinë e kufizuar.

VKM nr.597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përftimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike”, i ndryshuar.

III. MASA E NDIHMËS EKONOMIKE

1. Ndihma ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndihmë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe

a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura

(treqind) lekë në muaj gjatë vitit shkollor.
- Anëtarët e familjes, fëmijë/jetimet që nuk janë në institucione për të cilët vërtetohet se janë vaksinuar sipas kalendarit të vaksinimit, marrin një shtesë në masën 100 (njëqind) lekë, për çdo vaksinë të kryer.

ra ose kanë të ardhura të pamjaftueshme; b) jetimë, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore; c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë; ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre; d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrin të mbrojtjes ose të urdhrin të menjëherëshëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore

12. Anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuara, invalid pune apo individ, përfittues i ndihmës ekonomike, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar

Neni 6

Autoriteti kryesor përgjegjës ka këto detyra:

c) mbështetjen në ngritjen e strukturave ndihmëse, në bashkëpunim me mekanizmin e referimit, për bashkërendimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave e të masave për të parandaluar dhe luftuar të

gjitha format e dhunës, si dhe plotësimin e tyre me gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e “përshtatjes së arsyeshme”, që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje, **përfshirë këtu asistencë financiare, si dhe shërbime mjekësore e sociale, sipas legjislacionit në fuqi;**

Neni 7

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore, në kuadër të zbatimit të këtij ligji, kanë këto detyra:

b) ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

1. Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”
2. VKM nr. 182, datë 26.2.2020 Për Përcaktimin e Masës, të Kriterëve, Procedurave e Dokumentacionit për Vlerësimin dhe Përfitimimin e Pagesës për Personat me Afërsi të Kufizuara, si dhe të Ndihmës Personale, ndryshe me VKM nr. 707, datë 9.9.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin

Ligji nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”

Neni 8

Përfytyes të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

- a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë së janë bërë të fillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë;
- b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit të sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë;
- c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të fillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar;
- ç) personat, të cilët janë deklaruar invalidë pune me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, që përfitojnë pension invaliditeti dhe shtesë mujore mbi të, sipas Statusit të Invalidit të Punës.

1. Personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë së janë bërë të fillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë;
2. personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, si dhe personat e paaftë për punë, sipas Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, të cilët nuk plotësojnë

1. Pagesë në formën e një shpërblimi mujor në lekë:
 - Masa e përfitimimit për personat me aftësi të kufizuar, për a) personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët deklarohen me vendim të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë së janë bërë të fillë, pavarësisht nga shkaku dhe moshë; dhe b) personat me aftësi të kufizuar, të cilët deklarohen të paaftë për punë me

dhe përfitim
e pagesës për
personat me aftësi
të kufizuara, si
dhe të ndihmës
personal”

Neni 11

Personat jopërfittues

Nga ky ligj nuk përfittojnë:
...dh) personat që trajtohen në institucionet
e përkujdesjes rezidenciale publike, të finan-
cuara nga fondet e buxhetit të shtetit, për
masën e ndihmës ekonomike apo pagesën për
aftësinë e kufizuar.

Neni 18

Përfitim nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor

Përfittuesit e ndihmës ekonomike dhe të
pagesës së aftësisë së kufizuar përfshihen në
kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë,
në kuptim të skemës së sigurimeve të de-
tyrueshme të kujdesit shëndetësor.

**VKM nr. 182, datë 26.2.2020 “Për Përcaktimin
e Masës, të Kriterëve, Procedurave e Doku-
mentacionit për Vlerësimin dhe Përfittimin e
Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara,
si dhe të Ndihmës Personal”, e ndryshuar.**

**I. KRITERET E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË
AFTËSISË SË KUFIZUAR** 1. Përfittojnë pagesë
të aftësisë së kufizuar personat e përcaktuar
në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 8, të ligjit nr.
57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën

kushtet ligjore për
përfittim të pen-
sionit të invalidite-
tit të punës sipas
ligjit të sigurimeve
shoqërore në
Republikën e
Shqipërisë;

3. personat me
aftësi të kufizuar,
të deklaruar të
fillë me vendim
të Komisionit
Shumëdisiplinor
të Vlerësimit të Af-
tësisë së Kufizuar;
4. personat, të cilët
janë deklaruar
invalidë pune me

vendim të Komi-
sionit Mjekësor të
Caktimit të Aftë-
sisë për Punë, që
përfittojnë pension
invaliditeti dhe
shtesë mujore mbi
të, sipas Statusit të
Invalidit të Punës.

vendim të
Komisionit
Mjekësor të
Caktimit të
Aftësisë për
Punë, si dhe
personat e
paafte për
punë, sipas
Komisionit
Mjekësor të
Caktimit të
Aftësisë për
Punë, të cilët
nuk plotësojnë
kushtet ligjore
për përfittim
të pensionit
të invaliditetit
të punës
sipas ligjit të
sigurimeve
shoqërore në
Republikën
e Shqipërisë
është 10 653
(dhjetë mijë e
gjashtëqind
e pesëdhjetë
e tre) lekë në
muaj.

e Shqipërisë”.

2. Personat me aftësi të kufizuara, që nuk plotësojnë kushtet ligjore për përfitim të pensionit të invaliditetit të punës sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të cilët me vendim të komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë një ndihmës personal me pagesë.

III. MASA E PËRFITIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

1. Masa e përfitimit për personat me aftësi të kufizuara, e përcaktuar sipas pikës 1, të kreut I, të këtij vendimi, është 10 653 (dhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) lekë në muaj. Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuara, i përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuara dhe pagesa e ndihmësit personal indeksohet çdo vit nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

7. Përfituesit e pagesës së aftësisë së kufizuara përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë, në kuptim të skemës së siguri-

- Të njëjtën masë pagese përfiton edhe ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuara, i përcaktuar në shkronjën “b”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

- përfitojnë pagesë në masën 200% të pagesës si person me aftësi të kufizuara gjatë kohës që ndjekin kursin e kualifikimit/vitin shkollor vetëm për një dhe gjatë një kursi kualifikimi/

meve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

8. Periudha e shërbimit si ndihmës personal për personat e përcaktuar në shkronjën “a”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të cilët nuk janë ekonomikisht aktivë dhe nuk përfitojnë të ardhura nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror, vlerësohet periudhë sigurimi, për efekt përfitim pensioni, barërlindjeje, aksidenti në punë, sëmundjeje profesionale dhe sigurimi shëndetësor. Kontributet paguhen në bazë të pagës minimale, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimit të detyrueshëm shoqëror, dhe përballohen nga buxheti i shtetit.

10. Përfitimi i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk llogaritet në të ardhurat e familjes, për efekt të llogaritjes së ndihmës ekonomike.

viti shkollor, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e kursit të kualifikimit/vitit shkollor.

- Personat me aftësi të kufizuar, të cilët ndjekin arsimin e lartë në programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, përfitojnë pagesë në masën 300% të pagesës si person me aftësi të kufizuar gjatë kohës që ndjekin studimet vetëm për një dhe gjatë një programi studimi, brenda afatit të përcaktuar për kryerjen e programit të studimit.

<p>Personat-Paraplegjik dhe Tetraplegjik</p>	<p>Ligji nr.8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” i ndryshuar</p>	<p>Ligji nr.8626 datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, i ndryshuar.</p> <p>Neni 15</p> <p>Invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, parësisht nga të ardhurat që përfitojnë nga shteti, marrin një shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, në masën e përctaktuar nga Këshilli i Ministrave. Kjo shtesë nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik. Invalidët kanë të drejtë për një pagesë, po në këtë masë, për kujdestarin e tyre, të zgjedhur sipas procedurave ligjore.</p>	<p>Paraplegjik nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e dy anësive të poshtme si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme.</p> <p>Tetraplegjik nënkupton çdo person që vuan nga paraliza e katër anësive si pasojë e dëmtimit të palcës kurrizore nga shkaqe të ndryshme dhe e klasifikuar si i tillë me vendimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë në Punë</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshihen nga taksat e drejt-përdrejta 2. Përfshihen nga pagesat për kontributet shëndetësore dhe u jep atyre të drejtën e përfitimit falas të barnave të mbuluara nga skema e sigurimeve të kujdesit shëndetësor si dhe përfitojnë një shtesë në të ardhura për mbulimin e shpënzimeve, të paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare 3. Përfitojnë fonde në arsimim 4. Përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. 5. Përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës së telefonisë fikse. 6. Marrin një masë shtesë në të holla për shkak të paralizës së tyre, e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekte të nivelit ekonomik, po në këtë masë përfitojnë edhe për kujdestarin e tyre. 7. Përfshihen nga taksat doganore për mjete, të cilat ndihmojnë në integrimin e tyre në jetë, përfitojnë këtu dhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre.
--	--	---	--	--

<p>Personat me status invalid</p>	<p>Ligji nr.7889, datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, i ndryshuar.</p>	<p>Neni 7 Invalidët e punës, që kanë qenë të punësuar në ndërmarrjet, institucionet shtetërore, ishkooperativat bujqësore, repartet ushtarake, si dhe ushtarët e shërbimit të detyrueshëm, që vuajnë nga sëmundje profesionale, të aksidentuar në punë dhe me sëmundje të ndryshme, që marrin pension invaliditeti, në mbështetje të ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionin e ish-anëtarëve të kooperativave bujqësore”, i ndryshuar dhe ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet</p>	<p>Personat me status invalid janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Personi i aksidentuar në punë 2. Personi i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme që përfiton pension invaliditeti nga sistemi i sigurimeve shoqërore. <p>Statusin e invalidit e gëzon personi i aksidentuar në punë, i sëmurë nga sëmundje profesionale ose sëmundje të ndryshme që përfiton pension invaliditeti</p>	<p>– Përfitojnë pension invaliditeti + përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paafësie, nga Buxheti i Shtetit. Kriteret e marrjes së përfitimit të paafësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.</p> <p>– Përfitojnë shërbim mjekësor në banesë falas.</p> <p>– Përfitojnë:</p> <p>a) mjete lëvizëse dhe pajisje të ndryshme ortopedike; b) mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale; c) mjete ndihmëse kardiale etj. Kriteret përcaktohen me rregullore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.</p> <p>– Përijshohen nga taksa doganore për mjete lëvizëse dhe ndihmëse.</p> <p>– Përfitojnë sipërfaqe të caktuara në shtëpi pushimi bregdetare, malore, balneare, ku bëhen përshatjet e duhura për mënjanimin e barrierave arkitektonike për paafësitë e kategorive të ndryshme.</p>
--	---	---	--	--

shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, **përfitojnë një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie, nga Buxheti i Shtetit. Kriteret e marrjes së përfitimit të paaftësisë dhe masa e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.**

nga sistemi i sigurimeve shoqërore sipas ligjit nr.4171, datë 13.09.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 4976, datë 29.06.1972 “për pensionin e ish anëtarëve të kooperativave bujqësore”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Përfitojnë udhëtimin me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas falas. Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas.
- Përfitojnë 50% të çmimit të biletës në shfaqje artistike, muze, ndeshje e manifestime sportive.

Përgjasohen nga taksat e drejt-përdrejta të parashikuara në ligjin nr.7680, datë 3.3.1993 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë”.

Personat me statusin e të verbërit	Ligji nr.8098, datë 28.3.1996 “Për Statusin e Të Verbërit”, i ndryshuar.	Neni 5 Pavarësisht nga të ardhurat e tjera që përfitohen nga shteti, të verbërit marrin një shtesë për shkak të verbërisë së tyre në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave e cila nuk llogaritet në të ardhurat familjare për efekt varfërie. Po në këtë masë pagesën e përfiton edhe kujdestari i tyre, të cilin e zgjedhin vetë.	Përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesëshëm shikimi, të lindur ose të ftuar, të cilët sipas kritereve mjekësore janë të paafte për punë në kushte normale	<ul style="list-style-type: none"> - Përfitojnë një shtesë për shkak të verbërisë së tyre. - Përfitojnë strehim nga shteti. - Përfitojnë arsim falas dhe gjatë kohës së studimit përfitojnë paguesin e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. Ata me gradë shkenore këtë pagesë e përfitojnë në mënyrë të përhershme. - Përfitojnë sigurimin shëndetësor, përfitimin e ilaçeve dhe pajisjeve ndihmëse mjekësore falas deri në masën e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave. - Përfitojnë së bashku me shqeruesin e tyre të udhëtojnë falas në transport urban dhe me gjysmë çmimi në transport interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat. - Përfitojnë të paguajnë 20% të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike, dhe diferencat paguhen nga shteti. - Përfitojnë hyrjen falas në mjediset kulturore.
		<p>Neni 15</p> <p>Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”.</p>		

Përftime të tjera

1. Ligji nr.121/2016 “Për Shërbimet me e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”
VKM nr.518, datë 04.09.2018
2. “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përftimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përftuesit e shërbimit të organizuar”

Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Neni 6

Përftuesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Përftuesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë këto grupe shoqërore: a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislationit në fuqi për azilin; b) personat me aftësi të kufizuara; c) të rriturit, me probleme sociale, viktimitat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit; ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare; d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë; dh) të moshuarit në nevojë.

2. Individit, i cili nuk përfshihet te përftuesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, sipas pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë, kundrejt

1. Familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmijën që gëzon mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislationit në fuqi për azilin; personat me aftësi të kufizuara; c) të rriturit, me probleme sociale, viktimitat e dhunës, trafikimit, varësisë së provuar ndaj drogës e alkoolit; ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare; të miturit dhe të rinjtë në konflikt me
- 2.
- 3.
- 4.

1. Përftojnë shërbime:

- a)shërbimet parashoqërore;
-
- b)shërbimet në qendrat komunitare, përshirë qendrat e zhvillimit;
- c)shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;
- ç)shërbimet shoqërore në situatë emergjence;
- d)shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror;

tarifave përkatëse, të kërkojë sistemim të përkohshëm në institucionet e ofrimit të shërbimit, qofshin këto rezidenciale apo komunitare, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, deri në mbarimin e rrethanave të veçanta për të cilat ka kërkuar shërbimin.

Neni 8

Llojet e shërbimeve të kujdesit shoqëror

1. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë të organizuara si shërbime në komunitet, institucione të kujdesit dhe familje për të gjitha kategoritë e identifikuara të përfituesve. 2. Llojet e shërbimeve shoqërore janë si më poshtë: a) shërbimet parashoqërore; b) shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit; c) shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat; ç) shërbimet shoqërore në situatë emergjence; d) shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror; dh) shërbimet e specializuara; e) shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror, me qëllim riintegrimin në shoqëri, si dhe ata që gëzojnë mbrojtje ndër-kombëtare me vendim të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë;

5. të moshuarit në nevojë.

dh)shërbimet e specializuara;
e)shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

<p>Strehimi</p>	<p>Ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”</p>	<p>Ligj nr.22/2018 “Për strehimin social”</p> <p>Neni 2</p> <p>Përkufizime</p> <p>44. “Të ardhura familjare” janë të ardhurat periodike që siguron familja nga pagat, veprimtaria ekonomike, paguesat që marrin pjesëtarët e familjes që kujdesen për personin me aftësi të kufizuara, interesat e depozitave bankare, të ardhura nga persona të tretë, qiratë nga prona të paluajtshme. Në këto të ardhura nuk përfshihen të ardhura nga ndihma ekonomike, pagesat e papunësisë, përfitimet e personave me aftësi të kufizuara, sipas statusit të invalidit të punës ose të luftës, nga ndihma ekonomike për shkak të aftësisë së kufizuar, e parashikuar në ligjin nr. 9355 datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, në ligjin nr. 8098 datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 8626 datë 22.6.2000, “Për statusin e invalidit paraplegjik e tetraplegjik”; nga rimbursimi i shpenzimeve për energji elektrike; nga rimbursimet për ilaçe e mjekime për të sëmurët kronikë dhe nga paketa</p>	<p>1. Çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesë jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave; - kanë mbetur të pas-trehë, si rezultat: i) i fatkeqësive natyrore; ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë; iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përgjashuara nga procesi i legalizimeve; nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë; - familjet që kanë një banesë të vjetër, në 	<p>Kategoritë sipas ligjit përfshijnë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> - programi i banesave sociale me qira, në vijim BSQ; - programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; - programi i banesave me kosto të ulët, në vijim BKU; ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehim; d) programi për krijimin e banesave të përkohshme; dh) programi i banesave të
------------------------	--	---	--	---

higjieno-shëndetësore për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 3

Parimi i përballueshmërisë së strehimit

1. Strehimi konsiderohet i përballueshëm nëse familja me të ardhura: a) mesatare nuk shpenzon më shumë se 25 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm; b) të ulëta nuk shpenzon më shumë se 20 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm; c) shumë të ulëta nuk shpenzon më shumë se 15 për qind të të ardhurave të saj mujore për sigurimin e një strehimi të përshtatshëm. 2. Në shpenzimet për strehimin nuk përfshihen shpenzimet për shërbime të furnizimit me ujë dhe me energji elektrike. 3. Strehimi i familjeve pa të ardhura sigurohet nga institucionet shtetërore, nëpërmjet njërës prej programeve të strehimit social të parashikuara nga ky ligj.

rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.

- Shtefasit e huaj, me qëndrim të rregullt në Shqipëri.
- të miturit nën moshën 18 vjeç, pas lirimit ose përfundimit të programit të masës alternative të shmangies, në rastin kur bazuar në një vendim gjyqësor ose një akt administrativ, mbeten të pastrehë, për arsye se nuk duhet të jetojnë me prindërit, kujdestarin ligjor ose me familjen e tyre.

specializuara.

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore
- kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfutues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfutuar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore.
- Individit/familja nuk mund të përftojë njëkohësisht nga më shumë se një program strehimi social në të njëjtën kohë

